



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË ,KOSOVO POLJE

Ekstrakti nga procesverbali, i-VII, i Kuvendit të Komunës, i mbajtur më datën 30.06.2025, ora 10:00, në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës: Ali Ismaili - Kryesues i Kuvendit të Komunës, Bashkim Krasniqi - Zëvendës Kryesues i Kuvendit të Komunës për Komunitete, Miranda Shabani, Mirlinda Krasniqi, Jetmir Berisha, Vjollca Konjusha, Krenar Dumani, Laureat Gojnovci, Jahush Krasniqi, Fisnik Sllamniku, Etnik Berjani, Durim Hajra, Hasime Kostanica, Shpend Bardiqi, Habib Mekolli, Vlonjat Hasani, Mirsad Qyqalla, Aida Alimi, Dardane Sogojeva Shala, Migjen Kolshi, Qëndresa Ademi, Artan Asllani, Arbnore Kelmendi, Hasan Ismajli dhe Radoman Doderovic.

Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës: Besnik Osmani - Nënkryetar i Komunës, Amir Bullatovci - Drejtor për Administratë, Fatlum Berisha - Drejtor për Arsimit, Bardhyl Kojçiçi - Drejtor për Infrastrukturë, Ardit Sekiraça - Drejtor për Shërbime Publike dhe Mjedis, Ilir Hasani - Drejtor për Gjeodezi Kadastër e Pronë, Vjosa Kida Hyseni - Drejtore e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Donat Zharku-Drejtor për Inspektoriat.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes dhe prezantoi këtë:

REND DITE

1. Betimi i anëtarit të ri të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës.
2. Aprovimi i ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 08.05.2025 dhe 22.05.2025.
3. Propozim për shqyrtimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet 2026-2028.
4. Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
5. Propozim për lejimin e mjeteve financiare për norma të reja në arsim për vitin shkollorë 2025-2026.
6. Propozim për lejimin e mjeteve financiare për norma të reja në shëndetësi.
7. Informatë e Drejtorisë së Arsimit për ndarjen e bursave për studentët e Komunës së Fushë-Kosovës.
8. Kërkesë për rishqyrtimin e vendimit Nr.47 sipas shkresës 020-327/6, të datës 13.06.2025, lidhur me fillimin e procedurave për revidimin e Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës.
9. Kërkesë për rishqyrtimin e vendimit Nr. 48 sipas shkresës 020-327/7, të datës 13.06.2025, lidhur me fillimin e procedurave për Planin Rregullues të Hollësishëm të Fushë-Kosovës.
10. Propozim-vendim për hapjen e shqyrtimit publik për Planin Zhvillimor Komunal 'Fushë-Kosovë 2025-2035'.

11. Propozim për lirim nga pagesa banorët e tri komunave të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanoveit.
12. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në mbledhje. Materialin e kemi marrë me kohë. Kjo është seanca e pestë e vitit 2025, me këtë Rend të Ditës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, lexoi pikat e rendit të ditës, po ashtu i falënderoj të gjithë të pranishmit e tjerë të cilët janë sot këtu me ne, në këtë seancë. Pika e tetë dhe pika e nëntë, ka kaluar në Komitetin për Politik dhe Financa, po ashtu dy vendimet të cilat janë kthyer nga Ministria për rishqyrtim, ndërsa pikat tjera nuk kanë kaluar. Dua që të ju sqaroj të nderuar anëtar të Kuvendit të Komunës, sepse pikën pyetje dhe përgjigje parlamentare e kam lëvizur unë personalisht dhe ju kërkoj falje, sepse me plan të punës i kemi pikë të dytë, por për arsye se unë kam qenë në Haxh dhe kam ardhur ditën e fundit për dorëzim të materialit dhe për arsye se afati i fundit për ta dorëzuar. Korrizën Buxhetore është data 30 qershor. Unë e kam lëvizur renditjen e pikave dhe e kam vendosur pikën e tretë, me qëllim që mos të humbim kohë dhe nëse kalon, të përgatitet vendimi dhe ta dorëzojmë me kohë. Me plan të punës i kemi edhe dy informata, informatën për Drejtorin e Bujqësisë dhe Informatën e Inspeksionit, i kemi lënë për seancën e ardhshme, z. Mirsad Qyqalla ka kërkuar në Komitetin për Politik dhe Financa që të jeto pikë e rendit të ditës edhe "Informatat e Inspeksionit", po ashtu znj. Aida ka kërkuar një raport të Komisionit të Rrugëve, që kanë qenë në Shqipëri, po dëshiron me sjell si pikë të rendit të ditës. Unë mendoj se kishte qenë mirë tek të ndryshme me dal dhe me e prezantua sepse ky është vetëm raport i punës së Komisionit të Rrugëve. Unë pyes, a ka dikush ndonjë propozim sa i përket rendit të ditës?

Durim Hajra: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, i nderuar Kryesues i Kuvendit, ka shumë Kryesues të Kuvendeve të komunave tjera, pikat të cilat nuk kalojnë në Komitetin për Politik dhe Financa, shumë prej Kryesuesve të tjerë nuk i sjellin fare në Kuvend, për arsye se nuk kanë marr rekomandim nga Komiteti për Politik dhe Financa. Ndërsa tek ne edhe pse nuk po kalon në Komitetin për Politik dhe Financa po arrijnë në Kuvend. Unë e di se në ligj nuk ka ndonjë nen që e definon këtë çështje, mirëpo dori sa po ke praktika nga të tjerët, ndoshta kishte qenë mirë me marr një mendim nga zyra ligjore si të vepron, Kryesues, harra ju bie juve se si duhet të vepron në këto raste.

Mirsad Qyqalla: Kërkoj që në mbledhjen e radhës të jetë pikë e rregullt "Informatat nga Drejtoria e Inspeksionit".

Hasan Ismajli: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në mbledhje. Kryesues unë e kam një propozim për një pikë shtesë për "Lirimin nga pagesa e shërbime shëndetësore për qytetarët e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanoveit, të cilët janë në pritje të dokumentit për të qenë shtetas i Republikës së Kosovës apo banor i Komunës së Fushë-Kosovës. Unë kam diskutuar edhe me Nënkryetarin e Komunës, i cili më ka premtuar që do të merret me këtë çështje, por realisht nuk është marrë asnjëherë. Unë kërkoj që ky Kuvend, ta nxjerr një vendim që këta banorë, të trajtohen njëjtë si banorë tjerë që janë banorë rezident të Komunës sonë. Kështu banorëve duhet të ju dalin

në ndihmë, sepse me të vërtetë e meritojnë dhe mos t'i penalizojmë me këto taksa që janë të pa përbeflueshme për ta. Sidomos për ata që janë mbi moshën 60 vjeçare, e ku nuk ju takon as pensioni i moshës. Kërkoj trajtimin e njëjtë si me banorët rezident të Komunës së Fushë-Kosovës, sepse ligjërisht është një nenë në Udhëzimin Administrativ, ku thotë: "Të gjithë ata banorë, që janë në proces të procedurës për marrjen e dokumentacionit, lirohen nga taksat prej 5€", unë e kam diskutuar edhe me Zyrën e Gjendjes Civile dhe kam marr informacion që çdo qytetar, që aplikon që të bëhet banorë i Fushë-Kosovës apo shtetas i Republikës së Fushë-Kosovës, e kren një dokument, kur ta dorëzojmë dokumentacionin

Vlonjat Hasanit: Kryesues një qytetar ka dërguar një kërkesë për ndihmë në shërim dhe nuk e keni sjellë në Kuvend, si pikë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: I nderuar, mua nuk më ka ardhur as një kërkesë për ndihmë në shërim, sepse do ta kisha sjellë në Kuvend, por ashtu sa i përket propozimit të z. Bashkim Krasniqit që z. Qerim Gara të hyjë si anëtar në Komitetin për Komunitete, dua të iu sqaroj se një here duhet të bëhet hetimi i anëtarit të ri, pastaj tek pika të ndryshme e propozon, sepse kjo është vetëm çështje procedurale dhe nuk besoj se ka ndonjë problem.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e hedhi në votim për aprovim pikën shtesë të propozuar nga asambleisti z. Hasan Ismajli "Propozoj trajtimin e njëjtë si me banorët rezident të Komunës së Fushë-Kosovës qytetarët e Komunës së Preshevës, Medvegjës dhe Bujanovcit".

U votua me "unanimisht për", asnjë votë "kundër" dhe asnjë abstenim, gjithsej nëntëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës në mungesë të votave nuk e vendos për shqyrtim në rendin e ditës "Kërkesat e z. Hasan Ismajli, që punëtorët e pastimit të lirohen nga pagesa për emërimin e shërbimeve mjekësore".

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për shqyrtim në mbledhjen e sotme në tersi rendin e ditës.

U votua me: unanimitet, kundër nuk ka dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e tre anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Kuvendit të Komunës me shumicë të votave, e aprovuan për shqyrtim rendin e ditës për mbledhjen e sotme.

Pika e parë (1): Hetimi i anëtarit të ri të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Në bazë të nenit 35 paragrafi 35.3 thotë mandati i çdo anëtarit të Kuvendit të Komunës verifikohet nga Komisioni për Verifikimin e Mandateve që themelohet nga Kuvendi i Komunës, para nënshkrimit të mandatit nga secili këshilltar. Etoj anëtarët e Komisionit për Verifikim. Nga Lidhja Demokratike e Kosovës u propozua: Fisnik Sllamniku-Kryetar i Komisionit, nga Vetëvendosja u propozua-Hasime Kostanica, nga Partia Demokratike u propozua-Dardane Segojeva, ju lutem verifikoni dokumentacionet.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Etoj Kryetarin e Komisionit për Verifikimin e Mandatit z. Fisnik Sllamniku, që ta marr gjalën

Fisnik Sllamniku: Përsërishtje të nderuar kolegë, Komisioni pas verifikimit përcaktoj se janë plotësuar kushtet në bazë të nenit 35, për emërimin e anëtarit të Kuvendit Komunal z. Qerim Gara

nga subjekti politik Lista ndryshe, duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z. Artan Asllani, obligohet që ky vendim ti dorëzohet z. Qerim Gara dhe të ndërmerren veprime procedurale për zbatim. Komisioni i Zgjedhjeve ka verifikuar të gjitha kërkesat. Andaj i urojmë suksese kolegut z. Qerim Gara.

Qerim Gara: Unë Qerim Gara, betohem solemnisht se do ti kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do ti ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, në mënyrë që të sigurohen kushtet për jetë të qetë për të gjithë”.

Pika e dytë (2): Aprovimi i ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 08.05.2025 dhe 22.05.2025.

Durim Hajra: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, duhet ta respektoni Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Rregulloren e Kuvendit.

Mirsad Qyqalla: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, duhet ta respektoni Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Rregulloren e Kuvendit.

U votua me: katërmëdhjetë vota ‘për’, asnjë votë ‘kundër’ dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzetë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Ne bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave i aprovoi ‘Ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhja e Kuvendit të Komunës të mbajtur më datën 30.06.2025

Pika e tretë (3): Propozim për shqyrtimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet 2026-2028.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ftoj Drejtorin e Buxhetit dhe Financave ta marr fjalën nëse është prezentë.

Shqiipe Islami: Përshëndetje për juve Kryesues, dhe ju të pranishëm. Pra, siç e ceku Kryesuesi po e prezantoj Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026-2028 të cilën e keni para jush. Pas pranimi të Qarkores së Parë Buxhetore 2026/01 nga Ministria e Financave dhe Transfereve e pranuar në muajin Maj, ne kemi hartuar Qarkoren e Brendshme Komunale 01 për të gjithë Drejtorët e Drejtorive të Komunës për të bërë planifikimin e Buxhetit për vitin 2026 dhe vlerësimet për vitet 2027-2028 sipas nevojave të domosdoshme të drejtorive të tyre përkatëse. Ju njoftojmë se kufijtë buxhetorë të përcaktuar në këtë qarkore janë bazuar në të dhënat zyrtare të regjistrimit të popullsisë, të publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës në vitin 2024, dhe të aprovuara me Vendimin e Qeverisë Nr. 08/251, datë 12.03.2025. Kufijtë buxhetor janë përcaktuar me numër të banorëve 63,949. KAB Komunale 2026-2028 është krijuar në përputhje me Udhëzimet e Qarkores Buxhetore nr. 2026/01, Buxheti i Komunes së Fushë-Kosovës për vitet 2026-2028 është: 2026 - 26,803,586 euro, për vitin 2027 – 28,359,191 euro, për vitin 2028 – 29,765,823 euro. Këto vlera i keni të paraqitura në Tabelën nr. 1 në Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026-2028. Vlerat janë siguruar nga dy burime kryesore: Grantet Qeveritare dhe të Hyrat Vetanake. Për vitin 2026 nga Qeveria janë ndarë 22,379,835 € ose 83.50% e buxhetit total, dhe të Hyrat Vetanake në vlerë prej 4,423,751 € ose 16.50%. Pra, totalin i Buxhetit të vitit 2026 në vlerë prej 26,803,586 € e përbën: Granti i Përgjithshëm: 12,603,039 euro që në përqindje është 47% e vlerës totale: Granti i Arsimit: 7,221,020 euro, 27% e vlerës totale: Granti i Shëndetësisë: 2,555,776 euro, 9.50% e vlerës totale. Të Hyrat Vetanake: 4,423,751 euro, 16.50% e vlerës totale. Të hyrat vetanake janë të paraqitura në mënyrë të detajuar në tabelën nr 2 të cilat e arrijnë këtë vlerë totale. Kur bëjmë

krahasimin e buxhetin me vitin 2025 dmth me vitin aktual, Granti i Përgjithshëm është rritur në vlerë prej 6,680,757 euro, 113.02 %: Granti i Arsimit: 1,690,230 euro, 30.56%: Granti i Shëndetësisë në vlerë prej 714,685 euro, 38.81 %. Të hyrave vetanake në vlerë prej 964,076 euro, 27.86%. Pra buxheti i vitit 2026 në krahasim me vitin 2025 është rritur në vlerë prej 10,055,748 euro 60.04%. Ky buxhet është shpërndarë në pesë kategoritë ekonomike ku e keni të paraqitur në tabelën nr 3 në KAB. Pra, po fillojmë me radhë:

1. Paga dhe Mëditje	–	11,098,312.88 euro
2. Mallra dhe Shërbime	–	3,057,122.12 euro
3. Shpenzime Komunale	–	428,400 euro
4. Subvencione dhe Transfere	–	1,708,751.00 euro
5. Shpenzimet Kapitale	–	10,511,000.00 euro

Në tabelat nr 4 dhe 5 ku është bërë shpërndarja e buxhetit për vitet 2027-2028 nuk do të ndalemi sepse janë vetëm projeksione, dhe sigurisht do të ketë ndryshime në të gjitha kategoritë për shkak të rritjes së popullatës. Ne tabelën nr 6 i keni të paraqitura Investimet Kapitale, të cilat janë financuar nga Transferet Qeveritare 7,796,000.00 euro dhe 2,715,000 nga të Hyrat Vetanake. Projektet Kapitale nuk po i lexoj një nga një sepse i keni para jush, por theksojmë që jemi në fazën fillestare ku do të jenë tri Dëgjime Buxhetore, dy në muajin korrik me datë 04.07.2025 dhe 18.07.2025 dhe një më 22.08.2025, ku do të merren kërkesat e qytetarëve do të shqyrtohen me ekzekutivin dhe do të inkorporohen në buxhet.

Laureat Gojnovci: Sa i përket Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitin 2026-2028, falënderoj Shqipe Islamin për laborimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitin 2026-2028, siç e dimë kjo kornizë është dokumenti i parë më i rëndësishmi mbi zhvillimin e komunës së Fushë-Kosovës, do të mbahen tri dëgjime publike për 'Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitin 2026-2028'. Kjo shpërndarje garanton në vija të trasha një zhvillim edhe të mëtutjeshëm të Komunës së Fushë-Kosovës, kjo qarkore vjen në bazë të regjistrimit të fundit të popullsisë nga agjensioni i statistikave të Kosovës, ne si subjekt i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrahim dhe kërkoj nga secili prej jush që ta përkrahni dhe të merrni pjesë në dëgjime publike.

Durim Hajra: Të nderuar të pranishëm, të nderuar qytetar të Komunës së Fushë-Kosovës, sa i përket Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitin 2026-2028, ka arsye shtesë se pse duhet sot me diskutua më gjatë se herëve të tjera, arsyeja e par është se kemi rritje të garantit qeveritar dhe se jemi në fund të mandatit dhe besoj se kjo Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitin 2026-2028, duhet me pa se çka kemi paraparë në të kaluarën dhe çka kemi shtua, kjo është një tregues se kah shkojnë politikat e zhvillimit të Komunës, në aspektin sipërfaqësor ka vërejtje shumë të mëdhaja dhe deri tani nuk janë marrë parasysh, por ne po i themi këtu në foltore për hire të qytetarëve, te cilët na kanë votuar për me ardhur në këtë Kuvend. Në këtë kornizë shohim prioritete, por unë mendoj se vetëm prioritete nuk janë, se edhe për shkak se ka rritje granti qeveritar, shohim vetëm fryrje të shumave për projekte të caktume dhe nuk shohim as një projekt të ri, shumë prej projekteve që e kalojnë prej 500.000.00€, janë projekte në vazhdimësi, në këtë tabelë shohim rregullimi i rrjetit të kanalizimit, që është projekt në vazhdimësi, shtrim të asfaltit, rikonstruim të

rrugëve që ka të bëjë me asfaltimet, ne nuk kemi raport për projektet të cilat janë implemetuar edhe pse janë të pakta ato projekte, ne këtu po e shohim një kornizë buxhetore e cila përsëritet prej viti në vit. Këtu dominojnë shpenzimet operative dhe shohim një mungesë të madhe të investimeve kapitale, tek subvencionet çdo herë kemi pasur vërejtjen tonë edhe pse është viti i fundit, realisht po e vërtetojmë se subvencionet gjithmonë janë keqpërdorur për një votë klientiste, ku u pan edhe ne ditët e fundit bursat në arsim. Tek mjedisi dhe infrastruktura, do duhej të ishte fokusi më i madh për shkak të problematikave kryesore dhe nuk ka ndonjë fokus në këtë drejtim edhe pse ka qenë premtim i Kryetarit nuk po e shoh që u parapa ndërtimi i asnjë çerdheje të re, Kryetari i Komunës i ka premtuar katër çerdhe dhe nuk e ka realizuar as një deri tash, këto kanë qenë vetëm premtime elektorale, për me vërtetua të gjithë këtë çka e thashë dhe me argumentua se cili është ai qelësi i suksesit, për me pas sukses edhe opozita edhe secili asamblistë këtu, për mos me pas një kornizë të tillë buxhetore, unë mendoj se është fokusi ose puna në atë drejtim që me rrit transparencën e Kuvendit Komunal, por edhe të ekzekutivit në përgjithësi, por unë mendoj se nëse sot, qytetarët e Fushë-Kosovës, kanë gjetje në të kalumen kishin pas mundësi edhe kishin pas qasje me dëgjuar ata se çka diskutohet dhe çka planifikohet, unë mendoj se shumë shpejtë dhe shumë më përpara ju kish shkurtua jeta e Lidhjes Demokratike të Kosovës, në Komunën e Fushë-Kosovës, tek pjesa e tabelës 6, që janë investimet kapitale, unë nuk po du mu ndal për shkak se ka shumë më shumë për me u diskutua, unë dua ta përmendi vetëm shkurtimisht disa prej tyre edhe për kundër faktit se janë 10.500.000.00€, investime kapitale në dispozicion, nuk ka projekte konkrete të cilat ndikojnë në zhvillimin e jetës së qytetarit ose që i përmbushin ato kërkesat, që kanë qenë në vazhdimësi, që shumë prej neve i kemi adresuar edhe në Kuvendin Komunal, pra edhe për kundër faktit që ne jemi në përfundim të mandatit. Tek pjesa ku janë të planifikuara investimet kapitale, të Drejtorisë e Zhvillimit Ekonomik, ne çka vërejmë këtu dhe çka është paradoksale shohim, që Drejtorisë e Zhvillimit Ekonomik, parasheh investimin në sistem solar, e që nuk ka asgjë të keqe, parasheh renovim të ndërtesave, por nuk e ka një raport kthyes, se çka ka ndodh me investimet e ngjashme, të cilat kanë qenë më herët dhe të cilat gjithmonë i kemi kritikuar, pra mungojnë dhe realisht tek Drejtorisë e Zhvillimit Ekonomik është dashur që të ketë projekte, të cilat do të ndikojnë në zhvillimin rural të Komunës së Fushë-Kosovës, që i nxit këta të afërt, ose që e rrit numrin e të punësuarve, mirëpo me quaj projekt madhor, renovimin e ndërtesave, kjo tregon shumë se kah po shkon buxheti në këtë rast. Tek Shërbimet Publike, mbrojtje civile dhe emergjencat është paradoksale që fokusi është në ujësjellës dhe kanalizim, blerje të automjeteve, realisht kishte qenë shumë e kuptueshme në investime tek mirëmbajtja e rrugëve dhe e parqeve, mirëpo nëse investimet kryesore kapitale kanë të bëjnë me fushën në domenin e Drejtorisë së Infrastrukturës në këtë rast, sinqerisht nuk po e shoh dhe po e vërteton atë që buxhetet dhe kornizat buxhetore bëhen shabllon, qysh janë bërë deri tash edhe ka një ndarje me shumë në aspektin e shumave të caktuara, duke e marrë për bazë, vetëm buxhetin final, sesa zhvillimin e qytetit. Tek Drejtorisë e Arsimit, po i shohim disa prej projekteve, të cilat janë paraparë në këtë kornizë buxhetore, përfshirë ndërtimin e shkollës, mirëpo ka renovime të shumta, realisht do të duhej të ishte edhe tek Drejtorisë e Arsimit, nëse po premtojmë dhe po paraqesim zhvillim, nëse dikun tjetër nuk është paraparë, të paktën Drejtorisë e Arsimit, u deshtë ta planifikon të paktën ndërtimin e një çerdheje, apo avancimin e digjitalizimit nëpër shkolla, për mos të marrur shumë kohë, e mi diskutuar projekt për projekt, për shkak se edhe ka nevojë për me u diskutua, mirëpo projektet të cilat janë paraqitur këtu mendoj se janë shabllon dhe po përsëriten nga viti në vit. Unë dua të ndalem edhe pak tek parafolësi atë se

çka e tha. Shefi i Grupit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, tha që ka projekte të reja, pyetje legjitime dua ta di cilat janë ato projekte të reja? Kjo Kornizë tha paraqet zhvillim të madhe, nëse paraqet zhvillim të madh dua ta di ku? Merre fjalën dhe repliko, tregona për projektet te cilat janë implementuar deri tash? Realisht e morri si merit rritjen e buxhetit e që realisht, vetëm nga grandi qeveritar, e nuk ka as një merit nga niveli lokal, që u rrit buxheti në këtë drejtim. Merit e organizatave buxhetore në këtë rast e Komunës së Fushë-Kosovës, është kur të rriten të hyrat vetanake, ajo është për me dal dhe mu lavdu, ajo është për me dal dhe me tregu që ne kemi punuar dhe ajo është për me dalë dhe me garantuar që ka një zhvillim, të qëndrueshëm të Komunës së Fushë-Kosovës, gjë që nuk ka ndodhë deri më tash. Ndërsa sa i përket propozimeve, kjo mbetet vetëm një thirrje false, që për mua është bërë edhe e pa dëshirume, që tetë vite del ekzekutivi, çoftë i asamblastëve qoftë drejtori dhe i bënë thirrje asamblastëve, qytetarëve ejani propozoni në dëgjime publike, vetëm propozime që ne i kemi dhënë kanë qenë 32 dhe asnjë nuk është përfshirë, për hir të korrektség është mirë mos me bërë thirrje sepse asgjë nuk mirët parasysht.

Mirsad Qyqalla: Përshëndetje për të gjithë. Urime për asamblastin e ri. Po filloj nga tabela Nr.1, ku prezantohet buxheti ndër vite është shpresëdhënëse, prej një buxheti i cili ka qenë 16.747.000.00€ sa ka qenë në vitin 2025, tash në vitin 2026 kalojmë në 27.000.000.00€, ku është një rritje prej 10.000.000.00€, mirëpo nëse vazhdon dhe del tek pjesa, ku këta kanë vendosur me investuar këtu, atëherë ne këtu nuk gjejmë asgjë tjetër, përveç se këto projekte me përshkrime të njëjta te cilat kanë qenë viteve të kaluara, vetëm se janë rritu shifrat, këtu është dashur me diskutuar dhe me nxjerr në sipërfaqe, është pjesa që përkundër kësaj infrastrukture dhe për kundër këtyre mjeteve, te gjitha investimet i ki si viteve tjera edhe pse kam shpresua se ka me qen një buxhet më i zgjeruar. Këtu ne këtë kornizë buxhetore kishe projekte te cilat i kemi pasur vazhdimisht. Po filloj nga projekti numër 6 ne secilin projekt e keni vendosur te njëjtin përshkrim: kamion me korpë, cisterne për pastrimin e rrugëve, mire por unë nuk e pata te qartë cilën e keni blere e te cilën keni me blere, këtu janë parashikuar 230,000.00€. Te projekti nr.8 e vërejta ndërtimin e rrugëve me zhavorr ne shumen e mjeteve financiar te parashikuara prej 250,000.00€, çdo herë kam dilema tek zhavorri se ku po shkon, me sa e din unë edhe një lende për zhavorrin ka shkuar ne prokurori dhe prape këtë vit e keni parashikuar, unë e di se as ju nuk e dini se ku do ta shtroni këtë zhavorr te cilin e keni planifikuar.

Me bëri përshtypje projekti me nr.10 'Ndërtimi i rrethojave me infrastrukturë përcjellëse ne varrezat e qytetit te Fushe Kosovës' në fshatrave Miradi e Epërme dhe Sllatinë e Madhe , te gjithë e dimë se Fushë Kosova, para se me vendose rrethojën e varrezave ka nevojë për një hapësirë për varreza dhe unë e pashe që nuk është parashikuar ne këtë kornizë buxhetore një hapësirë për varreza as ne Fushe Kosove e as ne Miradi te Epërme unë vetëm pashë ndërtimin e rrethojave me infrastrukturë përcjellëse për varrezat. Ne fshatin Sllatinë e Madhe me sa e di unë varrezat janë te rrethuara, rrethojat janë dhe kemi pasur mundësi te investojmë shumë ma shumë diku tjetër. Projekti nr. 11 ndërtimin i pikave grumbulluese për mbeturina ne Fushe Kosove janë ndare 130,000.00€ nuk po e kuptoj a jena duke folure për vazhdimësinë e këtyre kontejnerëve, që këtë unë gjithë qysh duhet me kundërshtua se ju absolut nuk e keni guximin asnjë pike te re askund me vendosë. Aty ku ju ka lejuar me vendose kontejner prej pa mundësisë e keni ndërtuar objektin për dy kontejner dhe një e keni lënë ne rrugë sepse nuk e keni guximin veç pak metra me shkuar dhe me vendose një kontejner për banoret për komplet lagjen për arsyeje se është një komune që nuk ka guxim me dale dhe me luajtur rolin e vete dhe me prezentuar se institucioni është vendim marres

dhe nuk kemi se çka me prezantua. Një pjesë tjetër që e pashe riparimi i rrugëve të asfaltuara neper vend banime ne shumen e mjeteve financiare prej 450,000.00€ ku ishin të përfshira të gjitha fshatrat si mundemi ne me dite drejtore se si dhe ku kane me u riparuar këto rruge, çdo here po mungojnë këto specifika të sakta, një qytetare dhe me ta parashtruar pyetjen këtu ne fshatin tim se çka ka me u punuar, jam i bindur që ju nuk e dini dhe pra këtu në këtë kornizë buxhetore i keni vendosur vetëm do shifra dhe nuk ka asgjë të qarte . Vendosja e ndriçimit publik dhe mirëmbajtja e tërësishme ne Fushe Kosove dhe fshatra në shumen e mjeteve prej 260,000.00€ unë mendojnë se sado që i rritni shifrat pa u marre me këtë çështje kurrë nuk kemi me mujt me arrit ndriçim dhe mirëmbajtje, sepse nga fshati që unë vi me vite kërkojmë një rrethoj tek stadiumi dhe çdo here arsyetoheni që nuk keni mundësi financiare dhe anenë tjetër ju çdo here keni këso shifra dhe unë pyesë se ka po shkojnë këto mjete dhe kush është duke i marre këto.

Shenjëzimi horizontal dhe vertikal i rrugëve në qytete dhe fshatra me beri përshtypje dhe dua ta ndaje një përvojë ne fshatin Bardhe që tri vite radhazi rruga e cila të dërgon tek shkolla fillore , kame bere kërkesë dhe kishin gjetur me i vendosur disa pengesa 2 muaj para fushatës është pak mire se qytetaret janë vetëdisuar dhe krejt se çka ndodhe ne këtë vite është çështje vote , sepse të gjithë e kane dite se ne këtë pjesë ka nevojë për shenjëzimin horizontal dhe vertikal, ne Fushë Kosovë të gjitha pengesat të cilat i keni vendosur i keni larguar dhe kjo i bije sikur ju doni ti keqpërdorni parat publike . Këtu dikujt po i hynë ne pune për me i fituar tenderët dhe këto pengesa të punohen një here ne vite.

Tjetrin projekte për ndërtimin e kanalizimeve ne fshatrat 'Sllatinë e Madhe dhe Sllatinë e Vogël' këtu dua të ndalem, ne vitin 2026 me folur për kanalizim është e tepërt e sidomos për fshatin e Kryetarit të Komunës se Fushe Kosovës. Unë mendoje se këtu është përgjigja se si është menaxhuar që 25 vite dhe sa na kemi punuar se pa ujë dhe kanalizime kjo dëshmon se sa kemi punuar mire, po kjo nuk është dashur të jete as pjesë e debatit. Tek infrastruktura rrugore projekti me nr. 17 ndërtimi i parqeve hapësirave të reja rekreative dhe këndi i lojërave neper vendbanime ne Fushe Kosove dhe fshatra për mua është e rëndësishme ta dimë se për çfarë parqe po bisedojmë , do parqe të cilat janë premtuar si mini parqe nuk janë kryer fare, një park i madhe i cili është premtuar të behet ne pjesën e kufirit me Obiliqin nuk është bere, për çfarë arsyeje ne i kemi ndare 350,000.00€ për cilat parqe po flasim për këtë arsye ky buxhet ishte dashur me qene më specifik, pa marr parasysh se kush e ka përgatitur këtë buxhet . Tek projekti nr.20 rregullimi ne rrugën "Dardania" që 15 vite është duke u diskutuar rregullimi i rrugës Dardania por prape nuk ka asgjë , vetëm atë që e vërejta nuk e kane emërtuar sheshi por vetëm rruga Dardania. Ndriçimin dhe largimi i tarracave këtu e keni publikuar edhe një njoftim për largimin e këtyre tarracave por nuk ka pasur lëvizje ne këtë drejtim dhe kjo ka qene arsyeja pse unë kame dashur se ne këtë mbledhje mos të përjashtohet pika e rregullt e cila ka qene me plane të punës 'Informata për 6 mujorin e pare nga Drejtoria e Inspektoratit dhe me pa se çka është duke ndodhur me këtë vendim, a keni filluar dhe a jeni duke e zbatuar këtë vendim, sepse ky është interes edhe i banoreve dhe i bizneseve, me dite se çka është duke ndodhur sepse janë parashikuar 550,000.00€ , prape po e them ashtu siç e tha edhe kolegu paraparakisht se të gjitha këto projekte vetëm i kishit përshkruar ashtu siç kane qene viteve të kaluara dhe vetëm i keni dyfishuar shifrat me tere këtë buxhet prej 26,803,586.00€ nuk keni qene ne gjendje me e vendose asnjë projekt të ri , unë e pashe që e kishit përsëritur 'Qendrën Multi funksionale a mundet dikush me na dhënë përgjigje se ku do të ndërtohet kjo qendër, me këtë projekt keni kandiduar ne zgjedhjet e kaluara dhe për 4 vite nuk e keni realizuar,

unë e di se edhe 40 vite me ju a dhënë mandat ju nuk do ta realizoni, por te paktën mos me prezantuar ma si projekt sepse i keni ndare afër 800,000.00€ se pse aty ky ju keni pasur me ndërtuar ju ka dështuar dhe nëse aty ka dështuar projekti ju është dashur që ta keni te qarte se ku dëshironi me vendosur, këtu nuk te bene asgjë me besuar se ky projekt ka me u realizuar.

Hasan Ismajli: Duke e parë materialin i cili na ka ardhur për Komizën Afatmesme Buxhetore për vitin 2026-2028, këta te cilët e kanë planifikuar këtë buxhet nuk e kanë planifikuar mirë dhe nuk i kanë paraparë disa çështje të rëndësishme. Nga janari i vitit 2022, kur unë kam filluar punën si asamblistë, shqetësimi im si qytetar i Komunës së Fushë-Kosovës, ka qenë mungesa e hapësirës për varreza dhe tërë këto vite, sa here që mu ka dhënë mundësia, kam kërkuar që të ndahet një pjesë dhe të sigurohet hapësira për varreza, ndërsa kjo kërkesë e imja asnjëherë nuk është marrur parasysh dhe nuk e pa skit marr as tash në këtë Komizë Buxhetore, me një rritje të buxhetit prej 10 milion, të paktën ta kishit paraparë një milion, sepse deri në fund të vitit nuk do të ketë më hapësirë për varreza, unë nuk jam duke e kuptuar se çka është duke ndodhur. Vërejtjen tjetër të cilën e pashë, projekti për ndërtimin e një shkolle në fshatin Lismir, një kohë në rrjete sociale qarkullonin takime me myftiun, z. Naim Tërnavë, sepse ai ju ka premtuar, për ta kaluar një pikë në Kuvendin Komunal, sepse nëse kalon unë do ta ndërtoj një shkollë në fshatin Lismir dhe tash çka ka ndryshuar pse kanë ndërruar fjalët, nuk po e kuptoj, sepse edhe myftiu nuk po e mbajka fjalën apo ju nuk doni me ngarkuar at dhe e keni marr përsipër, por e pash që kishit planifikuar. Bashkëfinancim nuk mundesh me bërë me Bashkësinë Islame, nuk është kjo OJQ-ë, bashkëfinancimi nuk ekziston. Projekti tjetër ishte ndërtimi i shkollës tek Xhigolt, në Fushë-Kosovë ka disa lagje te cilët jetojnë Xhigolt, nuk janë të përcaktuar vetëm në këtë pjesë, sepse Xhigol ka edhe në qytet edhe në rrugën Dardania' janë edhe do në rrugën drejt Prishtinës, por pyes ku ka parcelë aty, sa është hapësira? Apo vetëm e keni paraparë tek Xhigolt, ta ndërtoni një shkollë. Projekti tjetër është ndërtimi i një shkolle në pjesën juglindore, këtu një pjesë e madhe nuk e kuptojnë kah i bien pjesa juglindore. Dua të ndërlidhem tek parafolësi, i cili e ngriti çështjen e Sheshit në rrugën Dardania', kur ne kemi thënë nuk ka shesh, ju thoshit që po ka shesh, tash e kishin ndërruar e kishin lënë rruga Dardania', aty nuk keni me mundur me bë asgjë, sepse edhe ato pemët dekorative te cilat i keni vendos, duhet me i larguar, duke i hudh në mbeturina nëntëqind mij euro. Keni planifikuar projektin, asfaltimi i rrugëve në fshatra dhe qytet, ku nuk keni treguar cilat rrugë dhe pastaj këtë e bëni sipas njerëzve dhe sipas votave. Ndoshta e keni menduar asfaltimin e oborreve private, sepse nuk e di a' ju ka mbetur ndonjë oborr privat pa shtruar. Në rrugën e Pejës, kemi problem me kontejnerët, prej te rreth rrotullimi, deri tek kompleksi i banesave ku banoj unë, janë tre kontejnerë dhe tërë ajo lagje aty i hedh mbeturinat, po ashtu edhe kalimtarët e rastit, ndalen dhe i hedhin mbeturina me thasë, po ashtu ka disa kompani-biznese, te cilat operojnë në këtë rrugë dhe një her sa hedhin mbeturina, kontejnerët më nuk zëjn, këtu ose nuk po guzoni ose nuk po doni, sepse ju duhet kontejnerin me ja dërguar para lokalit, sepse ajo pronë nuk është private. Keni filluar me i pastruar rrugët me një kamionët dhe me të vërtet po pastrohen mirë, por edhe kjo rruga e Pejës duhet te pastrohet sepse në Fushë-Kosovë është, unë e di që para dy viteve një kompani e quajtur Bageri', e ka marr kontratën prej qeveris për me mirëmbajte këtë rrugë dhe kjo kompani asnjëherë nuk e ka pastruar këtë pjesë, andaj së paku ju ta pastroni sepse na mbyti pluhuri dhe mbeturinat.

Bashkim Krasniqi: Përshëndetje për të gjithë, urime për asamblistin e ri dhe i dëshiroj punë të mbarë. Unë pyes pse nuk është paraparë asgjë në lagjet tona, sepse ne komuniteti jemi afër 100

shtëpi, me afro 5000 banorë, në këtë Kornizë-Buxhetore ishte e planifikuar vetëm rruga 'Pashko Vasa' dhe ajo rrugë është diku afër 50 metra asfalt. Ne biseduam edhe me z. Qerim Gara dhe ne sot do ta votojmë këtë Kornizë-Buxhetore, mirëpo nëse nuk ndryshohet dhe nëse nuk planifikohet asgjë për lagjet tona, më ne nuk do ta votojmë.

Aida Alimi: Përshëndetje për të gjithë, për shkak që me profesion jam ekonomiste, nuk pata mundësi pa dal në foltore, me 10 milion rritje të buxhetit është dashur që të planifikoni projekte të reja, e jo një përshkrim dhe rritje të projekteve të mëhershme, mirë do të ishte që në këtë Kornizë Buxhetore të ishin të paraqitura edhe projektet të cilat kanë përfunduar. Këtu ne nuk kemi asnjë projekt me zvogëluar numrin e papunësisë në Komunën tonë, që rinia mos të na ik, keni pasur mundësin me fut shumë projekte të reja, Mua po më vjen keq që pas shumë viteve, dikujt këtu po i bien ndërmend për pllaka memorialë, kjo është pjesë e ndjeshme e shoqërisë sonë, ju kisha lutur që mos me përdor për favore politike, sepse pas 26 viteve ju ra ndermen me shtrua iftar për familjet e dëshmorëve, e ku edhe në at iftar nuk janë ftuar të gjitha familjet, por vetëm disa. Unë nga kjo foltore kam bërë thirrje që ministria e ka një afat për pllaka memorialë, më keni thënë kush po ju informon edhe je duke e përdorur politikisht këtë, e tash e pasni futë në Kornizën-Afatmesme Buxhetore, po më vjen mirë që diskutimi im ka pas ndikim. Pas 26 viteve zhavorr, ju është dashur krejt Fushë-Kosovën me pas me asfalt, mos me pas nevojë për zhavorr më, por realisht i keni dëmtuar edhe qytetarët sepse u' a keni shtruar oborret. Projekti tjetër ishte ndërtimi i parqeve, kisha dashur ta di cilat parqe? Trotualet nuk janë funksional. Sheshi 'Dardania', unë çdo her kam thënë të jeni të kujdesshëm në shprehje, nuk ka sheshe, sepse për një shesh duhet të plotësohen disa kritere.

Vlonjat Hasani: Përshëndetje për të gjithë, urime për kolegun e ri. Sa i përket planifikimit buxhetor, ju nuk keni as tendencë me i planifikuar projektet në të mirën e përgjithshme. Ne kemi thënë edhe në të kaluarën, që të gjitha kërkesat të cilat adresohen edhe në kuvendin komunal edhe ato që propozohen të futen në planifikimin buxhetor. Ne kemi një rritje prej 10 milionëve dhe nuk ka ndryshuar absolutisht asgjë, në raport me këtë planifikim të buxhetit. Me rritjen e buxhetit është dashur të rriten edhe projektet, sepse kur mjete financiare kemi më shumë edhe projekte mundemi me bërë më shumë, por këtu me rritjen e buxhetit janë shkurtuar projektet e çuditshme. Jan të planifikuara ndërtimet e tri urave, ka pas kërkesë edhe zyrtare për ndërtim të urës në Miradi të Epërme, kjo nuk është askund, pastaj ndërtimi i rrugëve me zhavorr ne kemi vetëm shifrën të pa detajuar. Ky ekzekutiv i ka mashtruar dhe i ka përdor politikisht qytetarët, në Miradi dhe në Fushë-Kosovë, për çështjen e varrezave, vitin e kaluar e ka hapur një kod për blerjen e varrezave, pastaj e kanë heqë atë kod, ndërsa tash na sjellin diçka qesharake, me bërë rrethojën për varrezat e vjetra, por për varrezat e reja nuk ofrojmë zgjidhje. Ndërtimi i kanalizimeve, në fshatrat' Sllatin e Madhe dhe Sllatinë e Vogël', procesmbajtësi i këtij Kuvendi e din me saktësi, që për çdo seancë është bërë thirrje dhe kërkesë që rruga Lumi' në Miradi të Epërme, ka nevojë urgjente për kanalizim dhe këtu është bërë një planifikim për kanalizim, ndërsa rruga Lumi' nuk është planifikuar, kjo është e çuditshme, mos thuani nuk e kemi ditur, sepse ju e keni ditur se kjo çështje u diskutua në çdo seancë. Ndërtimi i trotuareve nuk e dimë sa është gjatësia, por vetëm shumën, ndërtimi i rrethojave për siguri në komunikacion, pyes a e keni ndërmend me bërë si në magjistrale, sepse me shumë keni bërë dëme dhe shkelje ligji. Projekti tjetër, asfaltimin e disa rrugëve, nuk ka specifika vetëm shuma. Asfaltimi në Miradi të Epërme, rruga Tregu i Madh' është planifikuar me u asfaltua kjo rrugë, unë nuk di se çka ka mbet tek jo rrugë mu asfaltua, sepse kjo rrugë është asfaltuar. Ndërtimi

i pllakave memorialë, janë paraparë 60 mij euro, duhet ta keni parasysh një element që në shtator bëhen katër vite, kur është vendosur gur themeli i pllakës memorialë te dëshmorit Imer Shala, atë e keni përdor vetëm për fushatë dhe më s'ka pas as një lëvizje për këtë pllakë memorialë, të paktën mos i përdorni politikisht dëshmorët, sepse qytetarët po kuptojnë që po doni mi shfrytëzua politikisht, renovimi i fushave me bari sintetik, është një turnir që organizohet në fshatin Miradi e Epërme dhe tash ka fillua mu bë tradicional dhe ju ka premtuar atyre që ju asnjëherë më nuk keni më zhvillu turnirin, për fusha private, ju ka premtuar fusha e futbollit të shkollës, që prej këtij viti mu përdorë, ka pas edhe zyrtar këtu te cilët kanë marr medalje, por fushën e futbollit nuk e kanë rregullua, tash është koha, kur do të fillon ai turnir dhe ata do të detyrohen me shkua dhe me mbajt në fusha private, kjo është turp me dal para tyre, i keni mashtruar.

Shpend Bardiqi: Përsëritet për të gjithë, pash në këtë Kornizë-Buxhetore, ndërtimin e shkollave dhe ndërtimin e çerdhes, kemi pas zotim prej qeveris për financimin e një shkolle.

Jetmir Berisha: Përsëritet për të gjithë. Unë dua të ndërlihem me Drejtorin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me ju treguar se fusha në fshatin Grabovc është ndërtuar e para në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës dhe ju ftoj që e keni mundësin me vizituar atë fushë, unë propozoj që kjo të futet në Kornizë-Buxhetore, sepse të gjitha këto fusha janë ndërtuar, më vonë dhe te gjitha janë me te rregulluara se kjo. Bari sintetik është shumë i dëmtum dhe kërkoj nga drejtori që të mirët parasysh kërkesa ime.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për shqyrtim në mbledhjen e sotme 'Kornizën-Buxhetore Komunale për vitin 2026-2028'.

U votua me: katërmëdhjetë vota për , kundër nuk ka dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Kuvendit të Komunës me shumicë të votave, e aprovoi 'Kornizën-Buxhetore Komunale për vitin 2026-2028' rendin e ditës për mbledhjen e sotme.

V E N D I M

1. Për aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale për vitet 2026 - 2028, në Komunën e Fushë-Kosovës, me kufijtë e caktuar buxhetor si vijon:
 - 1.1 Për vitin 2026 buxheti i komunës është në shumë prej: 26,803,586.00€;
 - 1.2 Për vitin 2027 buxheti i komunës është në shumë prej: 28,359,191.00€ dhe
 - 1.3 Për vitin 2028 buxheti i komunës është në shumë prej: 29,765,823.00€.

Pika e katërt (4): Pyetje dhe Përgjigje Parlamentare.

Laureat Gojnovci: Në vitin 2025 ka qen i planifikuar i ndërtimi i unazës në fshatin Lismir, me sa kam informacione edhe projekti ka shkuar në Ministrin e linjës, për pjesën te cilën nuk mund të përfshihet në unazën e fshatit, përfshirë në projektin te cilin ka qen bashkëfinancim me Ministrin e Infrastrukturës, nuk po e di deri ku ka mbërri me procedurë, por realisht mjetet financiare kanë qenë të ndara, projekti është shpallur, por nuk e di pse nuk po fillojnë punimet, pyes pse nuk po fillojnë punimet?

Durim Hajra: Pyetja e parë, ka të bëjë me një kërkesë, te cilën një qytetar e ka adresuar tek Drejtorja e Inspektoratit, një operator i cili operon në fshatin Harilaç, e që realisht banorët po i shqetëson aty zhurma dhe ndotja e ajrit edhe pas orarit të punës, kërkesën e ka bërë para dy jave edhe desha ta pyes Drejtorin e Inspektoratit, a i ka ndërmarrë hapat e nevojshëm, për të ju

përgjigjur banorëve të fshatit Harilaq. Pyetja tjetër ka të bëjë me angazhimin, e disa ekspertëve, konkretisht, më bëri përshtypje që ish zyrtari, i zyrës së prokurimit është angazhuar si ekspert z. Bedri Obërtinca, desha të pyes a nuk pat ekspert tjetër të kësaj fushe apo pikërisht ky. Ne e dimë se zotëria ka një lidhje me subjektin e Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe ka shërbyer gjatë kësaj. Projekti i cili është duke u implementuar në rrugën Dardania, Pajazit Islami, 28 nëntori, Shefki Kuleta, Hamdi Graicevci' Bedri Pejani në Fushë-Kosovë, por edhe në disa fshatra, unë jetoj në rrugën Pajazit Islami dhe pashë, që është duke u implementuar nga operatori ekonomik, nuk është duke u impelmentuar ashtu siç janë para masat dhe parallogaritë dhe kushdo që është menaxher i kontratës apo mbikëqyrës i punimeve duhet me ndërmarr masa, që mos të lejohet që me shkuar punimet kështu. Unë po e ri përsëris një kërkesë të cilën e kam bërë për Drejtorin e Kadastrit, Gjeodezisë dhe Pronës, me pas qasje në një vendim të gjykatës për parcelën P-725410-036-0428-3, në zonën kadastrale Fushë-Kosovë, po ashtu e kam adresuar edhe në mbledhje të Kuvendit dhe ju kam drejtuar edhe me e-mail zyrtar Kryetarit dhe Nënkyetarit të Komunës, lidhur me një propozim të cilin e kam bërë, që objektin e AMF-së, në lagjen Dardania, ta dhëjmë në shfrytëzim stacionit policor, ashtu siç kanë kërkuar, që të shfrytëzohet për nënstacion. Nuk kam marr përgjigje edhe pasi që e kam dërguar me shkrim, pres edhe në këtë mbledhje nëse mundet dikush me na u përgjigj në këtë çështje. Projekti i drunjtëve dekorativ, kur është afati final mu përfundua?

Mirsad Qyqalla: Dua të pyes për afatin e kontratës së drunjtëve dekorativ, ku mbledhjen e kaluar drejtori ka thënë që jemi në kohë. I nderuar drejtor edhe raporti i auditimit, e kish gjet të njëjtën vërejtje dhe nuk ka përfunduar ende ky projekt, po ashtu ka gjet se rrethoja e drunjtëve është jashtë standardit. Unë Nënkyetarin Komunës e kam pyetur se a mundemi me i besua raportit të auditorit dhe a është kredibil ky auditor, Nënkyetari më ka thënë 100% është i saktë. Tek Drejtorja e Arsimit, dua të pyes për shpërndarjen e bursave e cila u bë, dua që të pyes, a 'ju ke kërkuar edhe votën? Unë kur kam kërkuar, listën e bursave, as numri personal nuk kishte qenë, e me bëri përshtypje ku tash i keni publikuar me fotografi, unë besoj se nuk e meriton një i ri, i cili e fiton një bursë, me ju ekspozua një incizimi dhe mu publiku, kriteret të cilat i keni publikuar ju, këta student i kanë plotësuar dhe për këtë arsye kanë përfutur bursën, është mirë që po mbështeten, por mendoj se me i mbajt ma larg politikës kishte qen edhe më mirë. Unë kam takuar përfutues të bursave, të cilët më kanë thënë jemi detyruar, me thënë që jemi jashtë vendit, për arsye mos me u publiku. Drejtori i Inspektoratit, muajin e par filloj disa përgjigje me na i kthyer, mirëpo këtu është e çuditshme, sepse sa do që të ndërrohen drejtorët, gjithçka jetë e njëjtë, nuk ka as një ndryshim, mos prezencën e kemi pasur edhe në të kaluarën, mos përgjigjen e kemi pasur edhe në të kaluarën, ju keni bërë një njoftim, kur nga data 15 qershor, do të fillojmë me lirim të hapësirave publike, ne duhet të dimë të përgjigjemi për qytetarët dhe bizneset, a' ka fillua dhe kur ka me përfunduar, cili standard ka mu përdorë. Dua ta pyes edhe Drejtorin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i nderuar unë isha para dy ditëve dhe e pash një turnir tradicional, i cili mbahet në fshatin Bardh i Madh dhe ky turnir zakonisht mbahet në muajin korrik, ju vazhdimisht jeni aty dhe i merrni do merita, je drejtor dhe unë nuk e kam atë problem, mirëpo problemi qëndron, duke e ditur kohën e caktuar kur ka mu mbajtur dhe duke e parë gjendjen e fushës, qysh ka mundësi me fillua me prish atë fushë dhe realisht, të gjithë ata djem të cilët e organizojnë, dhe e pash që kishin bërë një punëtor duke u munduar, mu përgatit për një ngjarje, për të cilën ju edhe në raporte, e keni prezantuar si arritje, si një sukses, unë vazhdoj me besuar kështu, mirëpo me i lënë në atë gjendje, ku ata me pasur nevojë, me mbledh qytetar dhe me i përfunduar punët, duke pasur një komunë mbrapa, me një buxhet

shumë të madhe dhe prap me gjet forcën dhe me marr një fjalim, mu po më duket e pa sinqertë, tërë vitin rri në heshtje dhe kur të fillon turniri jeni prezentë. Të nderuar nëse nuk jeni mbështetës, mos e ua vështirësoni punën.

Hasan Ismajli: Pyetjen e parë e kam për Drejtorin e Inspeksionit, është një shtëpi këtu tek rruga e tregut, që del në lagjen 028-029, e cila është duke u ndërtuar me një marrëveshje, ndërmjet Kryetarit të Komunës dhe me një OJQ-ë, unë desha të pyes Drejtorin e Inspektoriatit, mirëpo me qenëse drejtori nuk është prezentë, dua ta pyes drejtorin e urbanizmit, se a' ka leje ndërtimore dhe nëse ka leje ndërtimore, a mundesh me na treguar se kush është pronar i kësaj toke? Dua ta di a' është dikush nga minoritetet: Rom, Ashkali, Egjiptian apo është i ndonjë komuniteti tjetër? Drejtor me sa unë kam informacion, aty është leshur një leje pjesërisht, nga drejtoria juaj, unë mesa kam njohuri leja është lëshuar për podrum dhe një kat, mirëpo aty janë ndërtuar edhe dy kate tjera, ku as me hart zonale nuk parashihet përveç përdhësës dhe një kat, desha ta pyes drejtorin e inspektoriatit, a ka dal në teren? a' kan bërë proces dhe nëse po çka është ndërmarrë? Dua prap një pyetje, e cila ndërlidhet me Drejtorin e Urbanizmit dhe Drejtorin e Kadastrit, para një ose dy viteve, e ke lëshuar një leje ndërtimore, tel lagjja 'Eliza C' dhe pas dy muajve me një marrëveshje të kryetarit dhe kompanisë së ndërtimit, janë akorduar, që për një lokal prej 400 metrave dhe për një parcel 1000 metra katror, me i dhënë dymbëdhjetë llamella edhe nga një kat ndërtues, drejtor para se të lëshohet leja ndërtimore, a' ka dal parcela prej 10 ari, në emër të Komunës, sepse ju duhet me ditë dhe ju me ligj nuk keni të drejt me lëshua leje, deri sa parcela nuk del në emër të Komunës, e pjesën e lokalit e kuptoj, sepse deri sa nuk bëhet pranimi teknik, nuk mundet me dal pronë e komunës, kjo pyetje lidhet me Drejtorin e Urbanizmit dhe Drejtorin e Kadastrit. Drejtori i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, e ka organizuar ditën e çlirimit të Komunës dhe për mu është respekt, mirëpo mua nuk më ka pëlqyer darka në mbrëmje, ku punëtori juaj poston, pije alkoolike, unë e di se ligji e ndalon, që me buxhet të Komunës, mu pagua pije alkoolike, a' i keni paguar ju apo ata prej gjepi nuk e di, por unë dua ta di si ka ndodh?

Vlonjat Hasani: Po filloj me problemin e rrugës Lumi në fshatin 'Miradi e Epërme', në të cilën nuk po ndodhë asgjë dhe nuk ka të planifikuar as me Kornizën-Buxhetore për vitin 2026-2028, thua se në të gjitha fshatrat kemi ankesa prej banorëve për rrugët, ku rrugët dytësore, rrugët kryesore janë, në gjendje të tmerrshme, e ne e dimë se jemi shumë afër zgjedhjeve dhe kjo është praktik e këtij ekzekutivi dhe rrugët shtrohen afër zgjedhjeve. Dua të pyes, se çka ka me ndodhë me kontratat e punës të cilat janë me projektin e Caritas Kosova, sepse ne kemi dëgjuar se ka përfunduar projekti, ndërsa disa punëtorëve ju keni thënë, ejani vetëm nëse doni me bë punë vullnetare, kjo çudia në komunën tonë nuk përfundon vetëm këtu, sepse ne e dimë nga përvoja e së kaluarës, që tash ju bëhet presion punëtorëve me projektin e Caritasit, që për me i sigurua votat, ua vazhdojmë kontratën. Mos i keqpërdorni, sepse përgjegjësia para publikut do të jetë mbi ju, nëse ka mundësi dikush me na dhënë përgjigje, se çka do të bëhet tash me këta punëtorë? Kemi ankesa nga qytetarët, për mos lirim të hapësirave publike, po ashtu a' ka mirëmbajtje në parkun rekreativ tek pishat? Tek Drejtoria për Shërbime Publike, në mbledhjen e kaluar jeni zotuar, se shumë shpejt keni mu marr me pastrimin e varrezave, ky veprim fatkeqësisht nuk ka ndodhë, pop ashtu oborret e shkollave, janë të tmerrshme, përfundoi viti shkollor dhe ka fshatra të cilat nuk i keni ndërhyrë fare? Këtë vitë vetëm keni shtruar zhavorr në oborr të shkollës, i cili ka filluar në kohën kur ka filluar procesi mësimorë, ku as një shej identifikuese nuk ka pasur dhe u rrezikojshin nxënësit. Ju e dini se ankesat e qytetarëve nuk ndalen asnjëherë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Një qytetar ka ardhur dhe është ankuar, unë e kuptoj sepse ai ka një hallë, ai ka një person me probleme shëndetësore në shtëpi, ky qytetar e ka sjell një kërkesë, para një muaji dhe unë mundova me ja sqaruar, se mu ajo kërkesë nuk me ka ardhur me protokoll, sepse unë te gjitha i pranoj me protokoll dhe i sjell në Kuvend, ai thotë se dikujt i ndihmoni në fshatin Dobrev dikujt jo, thotë se për dikun, brenda ditës e përfundoni, ai nuk e kuptojke se asamblisti ka të drejtë, me propozuar pik shtesë dhe për ata ka përfunduar brenda ditës. I nderuar Drejtor i Administratës, tu kisha lutur që me u merr, me këtë qytetar dhe me sqaruar ku janë dokumentet e tij? Unë ja sqarova se zyrtarisht nuk me ka ardh asgjë. Për Drejtoreshën e Bujqësisë, kohët e fundit kam marr disa ankesa nga qytetarët, që edhe serrat edhe kultivatorët edhe te gjitha shpërndarjet te cilat janë bërë, janë bërë mbi bazën politike, në fshatin ku unë jam imam, pretendohet se ka ndërhyrë z. Etniku zyrtarisht dhe i ka larguar prej listave, këtu është mirë Drejtoresha e Bujqësisë, fillimisht me publikuar listën dhe unë e njoftoj qysh sot se këtë lënd do ta dërgoj në prokurori, për arsye se zyrtari i komunës, ku mundem me emër dhe me mbiemër me thënë, e kanë marr serrën dhe e kanë shitë, nëse zyrtari i komunës merr një serrë, këtu i bie që nuk është në rregull, po ashtu ta shitesh një aset të komunës, të cilën e lidh një marrëveshje me qëllim të ruajtjes, le ta din se unë këtë lëndë do t'ia dorëzoj në prokurori. Në Drejtorin e Kulturës, nëse z. Samir Shahini, na ka thënë që ligjërisht nuk bënë, kur ti publikojnë listat e bursave me javë qit emrat dhe mbiemrat, sepse e shkel privatësinë, pyetja shtrohet nëse Nënkryetari Besnik Osmani, bënë spote me privatësinë e studentëve, nuk e di a' ka bërë privatësi edhe të atyre që u' a keni paguar minibusat, po ashtu keni subvencionuar disa me nevoja të veçanta, pyes a' e keni shkelur privatësinë e studentëve, kur ju për 10-15 vite ose na keni gënjyer ose na keni keqinterpretuar, në kuptimin e asaj që është një ligj dhe shkelet ligji, sepse privatësia e studentit dhe individit nuk shkelet, e ju në anën tjetër bëni thirrje masive. Dua ta parashtroj një pyetje për Drejtorin e Zhvillimi Ekonomik, a do ta publikoni listën e përfituesve të subvencioneve, sepse unë mendoj që edhe këtu ka shkelje, këtë do ta vërtetoj dhe nëse gjej diçka edhe këtë lënd do ta dërgoj në prokurori, po ashtu është mirë me shikua 10 përfitues nga komuniteti, a' i kanë plotësua kushtet dhe a' e kanë merituar me përfitua, sepse kjo me shumë ka për qëllim mbledhjen e votave. Drejtorit të Kadastrit dua ta pyes, kur do ti publikoni pronat?, unë kam menduar se keni me bë ndryshim, mirëpo nuk po duken, ju jeni i obliguar ligjërisht me i publikuar pronat, ka shumë vendime te cilat janë kthyer nga Ministria, për arsye se nuk i kemi publikuar paraprakisht pronat komunale. Dua ta pyes Drejtorin e Shërbimeve Publike, tek rruga Pajazit Islami', punën te cilën janë duke e kryer ata operator, nuk është aspak e mirë, unë po shpresoj, që menagjeri i kontratës do të mirët me këtë çështje, aty për një kabllo, është duke u dëmtuar gjithë trotuari dhe nuk e di se a do ta kthejnë në gjendjen si u kanë, por shpresoj që të ndërmermi masa. Deri tash i ke nejt gati punëve dhe je kanë përgjegjës. Dua ta pyes, kur do ta bëni kanalizimin, hapësirën për varrezat, por këto pyetje do i parashtrojmë gjat debatit publik.

Drejtori i Arsimit: Përshëndetje për të gjithë. Unë e di se fushata nuk ka filluar ende, bursat në Komunën e Fushë-Kosovës, si në këtë vit si në vitet paraprake, është i njëjtë, në këtë vit nga subvencionet e planifikuara për vitin 2025, kanë përfituar 854 persona, nga ta janë, 461 student bachelor, 140 master, 70 fëmijë me nevoja të veçanta, 200 nënës te cilëve ju ka paguar transporti dhe dhjet botime letrare, këto i potencova me qëllim, nëse dikush nga ju, e gjen vetëm një rast ku unë si drejtor, e kam bërë një privilegj, për shkak se ai i takon një subjekti politik tjetër, unë do të jap përgjegjësi. Ky event është propozim i imi, për një arsye, ku mjetet financiare, te cilat ju dhajm në

shfrytëzim, secilit student, janë ftuar vetëm studentët bachelor dhe master në këtë event për ta nënshkruar deklaratën në betim, secili prej jush e ka plot gojën transparencë dhe kjo deklaratë ka të bëjë pikërisht me llogaridhënie, në fund të vitit auditori mundet me kërkuar nga unë, arsyetim prej qytetarit, në këtë rast prej studentëve, se ku i ka shpenzuar ato mjete financiare, unë me përpilimin e një deklarate, e kam detyruar studentin me nënshkruar dhe mu betuar se këto mjete financiare, janë për studime. Nëse keni familjar te juaj përfitues, shikoni se çka thotë në deklaratë, mjetet financiare te cilat i ipen studentit, duhet që ti përdor për studime. Ju e dini se në Universitetin e Prishtinës, fakulteti nuk është me pages, mirëpo ata mund ti sjellin biletat e transportit publik, blerjen e librave, transkriptave. Nuk janë ftuar fëmijët me nevoja të veçanta dhe transporti i nxënësve. Mua më ka obliguar udhëzimi administrativ, për nxënësit që janë me larg se 5 km, me ua paguar transportin.

Botimet e librave, unë me kënaqësi i subvencionoj dhe kam dëshirë sa ma shumë me pas botues të librave. Kryesues sa i përket publikimit të emrave, ligji për mbrojtjen e të dhënave është në fuqi, unë qe dy vite i publikoj me emër dhe mblemër të gjithë studentët që kanë përfituar bursa, unë nuk mbaj përgjegjësi për ata te cilët kanë thënë në të kaluarën, por edhe këto bursa tash që janë dhënë do ti kesh të publikuara në web-faqen e komunës, ndërsa sa i përket fëmijëve me nevoja të veçanta, unë mundem me publikuar vetëm numrin e kërkesës zyrtare.

Hasan Ismajli: Drejtor çdo nënshkrim i cili qitet je i obliguar me ua dhënë edhe nga një kopje, sepse ligji ju obligon. Studenti nuk ka kopje, ju u desht me ja dhënë.

Drejtori i Arsimit: Te gjitha unë i kam në dosje.

Drejtori i Kulturës, Rinisë dhe Sportit: Sa i përket fushës në fshatin Bardh të Madh, pyetja e cila ishte për rrethojat, e kemi konstatuar me ekspertët, që ajo rrethoj nuk guxon te mbetet ashtu siç ka qenë, sepse paraqet rrezik për fëmijët aty dhe kjo ka qen arsyeja pse e kemi larguar, nuk kemi as një angazhim për rregullimin e asaj fushe, sa i përket komunës e nëse punon ndokush vullnetarisht unë nuk e di. Sa i përket ditës së çlirimit, unë po mundohem me bë më të mirën e mundshme për qytetarët e komunës së Fushë-Kosovës, në darkën e festes së çlirimit të ditës së Fushë-Kosovës, unë i kam kontrolluar te gjitha faturat dhe me dokumentacion dhe fatura nuk ka pasur pije alkoolike, ndërsa qysh i kam paguar dhe si i kam marr nuk edi sepse nuk kam pas mundësi me i përcjell të gjitha.

Drejtori i Shërbimeve Publike: Haxh të pranuar për ju Kryesues dhe për z. Krenar Dumanin. Dua të përgjigjem z. Durim Hajrës për ndriçimin e ri, në rrugën Pajazit Islami, për me pa si ka punuar kjo kompania, ju ftoj me shkuar dhe me shikuar rrugën e pishave, në Sllatinë dhe është i njëjti, nuk ka mundësi mos me qen 70 cm thellësi hapja në rrugën Pajazit Islami', sepse vet luga e bagerit është më shumë se 70cm, ndoshta ka ndonjë vend qe nuk është 70cm, mirëpo ka vende që ka qen me shumë se 70cm. Rruga 'Pajazit Islami', do të ketë ndriçim në të dy anët dhe do ti plotësoj kriteret e një rruge moderne. Punimet munden mu dokt të vrazhda mirëpo kompania është duke punuar. Pemët janë mbjellë, ndriçimi po përfundon, do të largohen edhe kabllot dhe do bëhet në infrastrukturë nëntokësore. Menaxherja është shumë e përgjegjshme, sepse është Inxhinieri e Elektros. Vendosija e pemëve dekorative, ka qen një projekt i suksesshëm, ju e dini se në lagjen 'Dardania' komplet e kanë ndërruar pamjen, këta drunj dekorative janë shumë të qëndrueshëm, ndaj kushteve atmosferike. Afatin e kemi vazhduar edhe për dy muaj, sigurimin e paguan operatori, po ashtu sa të vazhdohet projekti edhe mirëmbajtja shtyhet. Po ashtu jemi duke vazhduar në rrugën

'Arbria' edhe aty jemi thuajse në përfundim. Kositja e barit, u bë që tri her nga muaji prill, ndërsa varrezat për herë të parë. Tek shkollat kemi kositur edhe brenda edhe jashtë.

Pika e pestë (5): Propozim për lejimin e mjeteve financiare për norma të reja në arsim për vitin shkollorë 2025-2026.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare për norma të reja në arsim për vitin shkollorë 2025-2026'.

Hasan Ismajli: I nderuar Kryesues, subjekti i Lidhjes Demokratike një nga një jan duke e lëshuar mbledhjen, ndërpreje krejt dhe nesër e vazhdojmë.

Laureat Gojnovci: Grupi jon Parlamentar sot ka planifikuar me përfunduar seancën deri në këtë kohë, që tash jemi. Mirëpo ne u zgjatëm shumë dhe po kërkojmë që seancën me vazhduar nesër, për arsyes, sepse e kemi të pamundur me nejt, po ashtu kolegu ynë ka rast vdekjes dhe kemi planifikuar me shkuar dhe mi shpreh ngushëllime. Këtë mbledhje edhe nëse e kishim vazhdua e shoh te pamundur me përfundua sot para orës 4-5, sepse ka pika te cilat secila do ti merr nga një orë debat, unë kërkoj mirëkuptim përndryshe ne jemi, të detyruar me lëshuar mbledhjen dhe ju mundeni me vlerësuar dhe me vazhduar.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Duke e pasur parasysh situatën, ju e dini që ne në bazë të praktikës duhet me vazhduar, në momentin që nuk kemi kuorum, ne e konstatojmë, që nuk kemi kuorum edhe nuk hymë në votim, sepse pa kuorum, s'mundemi me hy në votim, ne do të vazhdojmë deri 4 ose 5, ne mund te fillojmë debatin për pikën e radhës nga drejtori dhe në votim e konstatojmë, po ashtu a e thirri nesër apo kur do të jetë në domenin tim sepse edhe un i kam disa punë që me duhet me i përfundua.

Hasan Ismajli: I nderuar Kryesues, pse ne po e shterim debatin sot.

Durim Hajra: Ne jemi të interesuar me dëgjuar sepse çështja është me rëndësi, sepse nxënësit kanë me mbetur pa mësimdhënës, kështu që vazhdoni, sepse nëse arsimi nuk është me rëndësi, atëherë çka është e rëndësishme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Drejtor laborona pikën dhe nëse nuk kalon sot, herën tjetër nuk ka nevojë më për sqarime, e qesim menjëherë në votim këtë pik të rendit të ditës, unë herën e kaluar nuk i kam lënë me zhvilluar debatin dhe kam dalur shumë keq, e kam konsumuar ligjin dhe ligji thot konstatimi për mbylljen e një seancës bëhet vetëm kur hedhet në votim dhe un kur ta hedhi në votim, e bëjë konstatimin, pastaj hecim tutje dhe nesër me vazhduar seanca, drejtori e ka përfunduar, ndëgjoni me vëmendje, sepse herën tjetër drejtpërdrejt votim.

Drejtori i Arsimit: Unë sot kërkoj mbështetjen e shumicës dhe shumica nuk po më dëgjon,

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Shumica është Lidhja Demokratike dhe ata e kanë lëshuar mbledhjen me vetëdije, njëri ka varrim, për bes te gjithë kemi punë më të mençur, se sa me ndejt këtu, të jesh i bindur, e qa ma pakë, me nejt opozita për diçka që nuk kanë me të votuar asnjë fare.

Durim Hajra: Ne kemi pas ndërmend me i votuar, sepse është shumë e rëndësishme.

Hasan Ismajli: Votën time e kam humbur sepse e kam pas ndërmend me i votuar.

Drejtori i Arsimit: Përshëndetje edhe një herë, në bazë të kërkesave te cilat u'a kam dhënë së bashku me materialin, më duhet me i sqaruar së pari, qarkoren buxhetore, ku kërkesat e mia janë të bazuara, në këtë qarkore buxhetore, numër 1508/2025, ministria e arsimit, ka kërkuar nga ministria e financave, aprovimin e 802 normave, për vitin shkollor 2025-2026, për Komunën e Fushë-Kosovës, por në parim, janë të aprovuara vetëm 740 norma, Komuna e Fushë-Kosovës, për

momentin numëron 696 norma, së bashku me stafin administrativ, të drejtorisë që është brenda. Keni parasysh, Ministria e Arsimit, kërkon 802 norma, për drejtorinë e Arsimit të Komunës së Fushë-Kosovës. Kërkesat e Ministrisë së Arsimit në Ministrinë e Financave, bazohen në sistemin SMIA, sistemi SMIA, është një platformë, ku bëhet regjistrimi i të dhënave, të nxënësve prej parashkollorëve, e deri në klasën e dymbëdhjetë dhe sipas kalkulimit të tyre, duke u bazuar edhe në numrin e nxënësve, përbrenda një klase, Ministria e Arsimit ka kalkuluar dhe ka rekomanduar që Komunës së Fushë-Kosovës, duhet ti takojnë 802 vende të punës, ndërsa në qarkoren e parë Ministria e Financave i ka aprovuar vetëm 740 norma, i keni të listuara dhe 102 prej tyre, minus 13 prej tyre mësimdhënës, që i kam shkruar pika 6, këta mësimdhënës, kanë të bëjnë me mësimdhënës të cilët duhet ti rekrutojmë dhe procesin mësimor ta fillojmë, në shtatorin e vitit 2025, do të thotë mësimdhënës jan 11, edukatore 2 dhe nëpunës teknik 1, sipas kërkesave të objekteve shkollore, që i kemi të gatshme dhe shtimit të numrit të nxënësve, për vitin 2025/2026, për me mundur me fillua, procesi mësimor në shtatorë të rregullt, neve na duhet 13 vende të punës, Ndërsa shuma tjetër e cila është e kalkuluar, prej 102 ka të bëjë me vitin kalendarik prej vitit 2026, Tek pika një dhe pika dy, kemi të bëjmë me udhëheqësin e institucionit parashkollor, tri objekte zyrtarisht i kemi sjell qe janë grant nga Ministria e Arsimit. Dua te ndalem vetëm tek pika e fundit, Sepse tek kjo pjesa e par nuk kam kërkuar mjete financiare, sepse mjetet financiare për vitin 2026 ju veç e potencuat, me herët qe rritet buxheti i komunës prej 10 milion eurove dhe këta mësimdhënës të cilat i rekrutojmë kanë mi pas vendet e veta në listë të pagave. Unë po kërkoj për 13 vende pune me kalua përmes Kuvendit.

Durim Hajra: Sa i përket çështjes së Arsimit në përgjithësi, unë mendoj si Kuvend Komunal, përfshirë këtu edhe opozitën, ndoshta në theks te veçantë kemi qenë gjithmonë, që me gjete zgjidhje dhe mi minimizuar sa ma shumë problemet të cilat i kemi me arsim në Komunën e Fushë-Kosovës, që prej mungesës së infrastrukturës e deri tek mungesa e normave, ku edhe sot po diskutohet, e që jo rrall herë e kemi dëshmuar që jemi për me gjete zgjidhje, për hire të nxënësve, Qe te paktën mësimdhënës me ju sigurua, është e çuditshme qe pozita e cila është e thirrur, me bë zgjidhje sidomos arsimit, e dëshmoj sot mos prezenca e tyre. Ne jemi dakordu se çka do qe ka mundësi Kuvendi me bë për arsimin është pak dhe duhet me bë ma shumë. Sot vet propozuesi i Lidhjes Demokratike nuk gjen kohë me nejt, opozita nuk mundet me ja zgjedh problemet, ne jemi me kontribu me debat dhe me votë, në mungesë të kuorumit kjo pik sot nuk klon.

Mirsad Qyqalla: Unë pajtohem plotësisht me parafolësin tim dhe kjo e shpërfaq këtë ekzekutiv, është paradoksale me ardh një pik kaq e rëndësishme dhe e lëshojnë mbledhjen pikërisht Lidhja Demokratike e Kosovës, ku kërkesa vjen prej Drejtorit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Nënkryetari është i degës së Lidhjes Demokratike të Kosovës, kjo është met habit me çfarë paradoksesh punojnë këta, e hala ma keq kur Shefi i Grupit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, thotë që na duhet me ndërpre sepse kemi me shkua në një të pame, e mbi te gjitha ne sot e kemi një dit pune dhe kishim mujt dikush me shkua dhe me përfaqësua at varrim, mirëpo tendenca qe nuk i kanë votat me than s'ka kuorum kjo pe shpërfaq nivelin e ekzekutivit, ju jeni fut një rrugë qorre ku as vet s' kanë fjalë, këtu e kanë humbur rrugën.

Hasan Ismajli: Ne mundemi me vazhduar, por ju kisha lutur me konsultuar ligjin, sepse në momentin që seanca ndërpritet dhe mbetet me vazhduar për herën tjetër, as një pikë nuk është e plotfuqishme, duke përfshirë edhe pikën e Kornizës Buxhetore, sepse me vetëdije e kan lëshuar seancën dhe kanë luajtur loja, kjo nuk shkon dhe unë deri ne fund kam me i shkua kësaj çështjeje.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:

Vazhdimi i seancës me datë 02.07.2025

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Përshëndetje për të gjithë. Ne e kemi diskutuar edhe pikën e pestë 'Propozimin për lejimin mjeteve financiare për norma të reja në arsim për vitin shkollor 2025-2026' në mbledhjen e datës 30.06.2025, Drejtori i Arsimit sot në mëngjes më ka informuar dhe ka kërkuar mirëkuptim, duke u bazuar në atë se në seancën e datës 30.06.2025, e ka sqaruar këtë pikë, drejtori është i ftuar në një televizion dhe i ka premtuar televizionit se do të jetë i pranishëm. Unë nuk dua të vazhdoj me këtë pikë të rendit të ditës, sepse e kam shter debatin në mbledhjen e kaluar, unë do të kaloj në votim për këtë pikë të rendit të ditës.

Laureat Gojnovci : Përshëndetje për të gjithë. Ne para vetës kemi një propozim nga Drejtoria e Arsimit 'Propozimin për lejimin mjeteve financiare për norma të reja në arsim për vitin shkollor 2025-2026', ku ne jemi të thirrur me shty përpara, për një arsye të vetme, mi lënë të gjitha akuzat dhe kundër akuzat, mes vete, qëllimet politike, punësimet, ne duhet të vlerësojmë dhe të mendojmë se nxënësit me datën një shtator, duhet ta kenë mësuesin/e në klasë në të kundërtën duhet të rritet numri i nxënësve në klasë me nga 50-60 nxënë. Kryesues kërkoj 10 minuta pauzë, pasi që dy anëtarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, janë rrugës duke ardhur dhe ky vendim është shumë i rëndësishëm për Komunën e Fushë-Kosovës dhe duhet ti japim mundësin edhe një her për ta proceduar në votim dhe të shohim a' janë numrat apo jo. Unë ju inkadroj edhe juve kolegëve nga opozita, që ta votoni, sepse ky vendim lidhet me të ardhmen e fëmijëve tonë, te cilët fillojnë mësimin me një shtator. Ky propozim, nuk duhet të jetë politik, 102 norma duhet me ju shtuar Komunës së Fushë-Kosovës. Kërkoj 10 minuta pauzë.

Hasan Ismajli: I nderuar Laureat Gojnovci, ju keni qen ai i cili keni dashur që mbledhja të mbahet sot në ora 9:00 dhe mbaje fjalën, sepse vet keni kërkuar në këtë orë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ju e dini se e kemi ndërprerë seancën me arsyet që ju e dini, unë i kam thirr shëfat e grupeve parlamentare në takim, unë mbrëmë kam folur shumë gjat në telefon dhe me ka thënë se ne do të vim në seancë dhe nuk do ta lëmë mu zhvillu mbledhje, sepse opozita ka kërkuar që seanca të mbahet të enjtën, jo sot. Mirëpo unë nuk i kam mirëkuptuar opozitën dhe e kam mirëkuptuar Kryetarin e Komunës dhe Lidhjen Demokratike të Kosovës, sepse jemi dakorduar me Kryetarin e Komunës që mbledhja të mbahet sot, duke filluar nga ora 9:00 dhe aktualisht ora është 9:25, nëse është një vendim i rëndësishëm ju duhet me ardh në ora 8:30.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për shqyrtim në mbledhjen e sotme 'Propozimin për lejimin mjeteve financiare për norma të reja në arsim për vitin shkollor 2025-2026'.

U votua me: njëmbëdhjetë vota për, kundër nuk ka dhe asnjë abstenim, gjithsej tetëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Kuvendit të Komunës me shumicë të votave, e aprovoi 'Propozimin për lejimin mjeteve financiare për norma të reja në arsim për vitin shkollor 2025-2026' dhe mori:

V E N D I M

Laureat Gojnovci: Nuk e murët parasysh kërkesë e grupit parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, kërkoj që ta qitni prap në votim këtë pikë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Kush është për ta marrë pauzën

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim, kush është për të shkuar në pauzë.

U votua me: njëmbëdhjetë vota për , kundër nuk ka dhe asnjë abstenim, gjithsej tetëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Kuvendit të Komunës se nuk mund të shkojmë në pauzë, për arsye të mungesës së votave.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Pas kërkesës së z. Laureat Gojnovcit, kërkoj që ta qes prap në votim pikën 'Propozimin për lejinin mjeteve financiare për norma të reja në arsim për vitin shkollor 2025-2026'.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për shqyrtim në mbledhjen e sotme 'Propozimin për lejinin mjeteve financiare për norma të reja në arsim për vitin shkollor 2025-2026'.

U votua me: njëmbëdhjetë vota për , kundër nuk ka dhe asnjë abstenim, gjithsej pesëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Kuvendit të Komunës me shumicë të votave, e aprovoi 'Propozimin për lejinin mjeteve financiare për norma të reja në arsim për vitin shkollor 2025-2026' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e shpalljes së një qind e dy (102) vendeve - normave të reja të punës në arsim për vitin shkollorë 2025-2026, si në Propozimin me Nr. 625, të datës 17.06.2025 - tabela Nr. 1 si vijon:

- 1.1 Dy (2) për drejtor të institucionit parashkollorë;
- 1.2 Një (1) - drejtor shkolle;
- 1.3 Pesë (5) këshilltar karriere;
- 1.4 Një (1) pedagog;
- 1.5 Tre (3) psikolog;
- 1.6 Trembëdhjetë (13) mësime;
- 1.7 Njëzet (20) mësime për zëvendësime;
- 1.8 Katër (4) sekretar/e të shkollave;
- 1.9 Gjashtëmbëdhjetë (16) edukatore;
- 1.10 Pesë (5) edukatore për parafillorë;
- 1.11 Dhjetë (10) edukatore mbështetëse;
- 1.12 Pesë (5) kuzhinier/e;
- 1.13 Njëmbëdhjetë (11) nëpunës teknik dhe mbështetës;
- 1.14 Gjashtë (6) shtëpiakë.

2. Për aprovimin e mbulimit buxhetor të pagave për katërmëdhjetë (14) punëtorët arsimorë jashtë listës së pagave dhe për trembëdhjetë (13) norma të reja të punës për periudhën

shtator - dhjetor 2025 si në Propozimin me Nr. 625, të datës 17.06.2025 - tabela Nr. 2 si vijon:

- 2.1 Njëmbëdhjetë (11) mësimdhënës jashtë listës së pagave;
- 2.2 Dy (2) edukatore jashtë listës së pagave;
- 2.3 Një (1) nëpunës teknik dhe mbështetës jashtë listës së pagave dhe
- 2.4 Trembëdhjetë (13) norma të reja për mësimdhënës.

- 3. Lejohet shuma e përgjithshme e mjeteve financiare prej: 77,246.40€, për pagesën e punëtorëve arsimorë të përshkruar në paragrafin dy (2) të këtij vendimi për periudhën shtator - dhjetor 2025.

Pika e gjashtë (6): Propozim për lejin e mjeteve financiare për norma të reja në shëndetësi.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për lejin e mjeteve financiare për norma të reja në shëndetësi'.

Drejtori i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale: Përshëndetje për të gjithë. Siç dihet me regjistrimin e popullsisë, kemi një rritje të madhe të popullatës, ku shtohet nevoja për rritje të stafit, në shëndetësi, sa i përket do analizave të cilat i kemi bërë dhe disa nevojave të cilat janë të nevojshme për staf në shëndetësi kemi paraparë, që na nevojiten edhe 43 pozita të reja në shëndetësi, unë kam dorëzuar materialin ku kam paraqitur, pozitat të cilat janë të nevojshme. Me datë 23.06.2025, kemi pasur mbledhje drejtorët e shëndetësisë, drejtorët e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe zyrtarë financiar komunal, ku kemi pasur propozimin e grandit specifik, i cili është bërë nga Ministria e Shëndetësisë, për kujdesin primar, i cili është bërë nga Ministria e Shëndetësisë, ku ka qenë e pranishme znj. Kadrie Berisha, zyrtare kryesore financiare, Shaban Osmani-Udhëheqës i divizionit të kujdesit parësor shëndetësorë, përmes Ministrit dhe përmes sekretarit të përgjithshëm të tyre, unë e falënderoj Ministrin e Shëndetësisë, të cilët e kanë laboruar shumë mirë grandin specifik për vitin 2026-2028, të cilët detajisht e kanë sqaruar dhe kanë propozuar në ministrin e financave. Një problem i cili është paraparë nga drejtorët e shëndetësisë dhe drejtorëve të Qendrës Klinike Universitare, bazuar në Udhëzimin Administrativ 04/2020, janë shtuar disa shërbime në shëndetësi, por në të njëjtën kohë nuk është rrit numri i stafit, ne bazë të udhëzimeve duhet të funksionoj Sektori i Urgjencës, ku Sektori i Urgjencës sipas grantit specifik llogaritet në 15 mijë banorë të jetë një ekip mjekësorë, me një mjek dhe dy motra, bazuar në regjistrimin e popullsisë ku ne i kemi 64 mijë banorë, na nevojiten katër ekipe mjekësore, katër mjek dhe tet infermiere, ku bëjnë 12 pozita të reja, unë e di se këtu ka asamblistë të cilët janë me profesion shëndetësorë, por nuk e di pse në sektorin e urgjencës, nuk është paraparë edhe vozitësi, me Udhëzim Administrativ detyrohem ta kemi edhe sektorin e shërbimit palativ ose vizitat në shtëpi, për personat të cilët nuk mundën me lëvizë, ku këtu na duhen dy ekipe mjekësore, një para dite dhe një mbas dite, gjithashtu na duhet sektori për vizitë të nënës dhe fëmijëve dhe këtu na duhet një ekip mjekësorë. Një problem i madh të cilin e përfshijnë të gjitha Qendrat Klinike Universitare, përfshin strukturat udhëheqëse në Qendrën Klinike Universitare, të cilat nuk janë të parapara si staf i veçantë, drejtori, kryeshefi, shefi, koordinatorja e cilësisë, motra kryesore, nuk janë staf i veçantë por llogariten në formulën e konceptit të mjekësisë familjare, në 2000 banorë,

ku do të thotë, drejtori z. Remzi Shala figuron në 32 mjek te cilët kemi të drejtë me punësuar ne, ky nuk është dashur me qenë aty, drejtori kryeshefi, shefi, koordinatorja e cilësisë, motra kryesore Duhet me qenë staf i veçantë, nuk duhet me hy në formulën e 32 mjekëve. Një çështje tjetër e cila u diskutuar edhe nga Ministria e Shëndetësisë, ku ju e dini se ligji për zëvendësimin e lehonave, në sektorin e arsimit është aprovuar, kurse në sektorin e shëndetësisë, nuk është aprovuar dhe drejtorisë së shëndetësisë po i shkakton vështirësi. Në këtë vite janë të lajmëruara 12 lehona, te cilat nuk kemi mundur me i zëvendësuar. Ne aktual i kemi 151 punëtor të punësuar dhe askush nuk mundet me ja mohuar pushimin e rregullt vjetorë dhe mesatarisht në muaj i bjen 13 punëtorë në ditë, me qenë pushim vjetor, pa i llogaritur pushimet mjekësore dhe pushimet e tjera në rast të vdekjes, fejesa, martesë. Duke i marr parasysh këto veçori te cilat i ceka, ne me drejtorin e Qendrës Klinike Universitare, kemi analizuar që afër 43 punëtorë, kishin mundur mi mbuluar këto probleme, duke u bazuar edhe në grantin e ministrisë, ku ata kanë thënë se ministria e financave nuk ju' a ka pranuar normat e reja sepse ne për Komunën e Fushë-Kosovës i kemi dorëzuar.

Laureat Gojnovci: Para se me përfundua këtë pik të rendit të ditës, kisha kërkuar nga Zyrtari i Lartë Ligjorë, një interpretim ligjor, kur në seancë janë 15 anëtarë, të Kuvendit, i merr 11 vota për, si duhet të vazhdohet dhe si duhet të procedohet. Kemi një shumicë të Komunave, ku votimet kalojnë me një shumicë, të thjeshtë të anëtarëve prezentë në Kuvend. Normat në arsim prej 15 pjesëmarrësve, patëm 11 vota për, unë personalisht do ti drejtohem Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe përgjegjësinë do ta merr dikush tjetër, unë po e shoh një koleg gazetar, ku kisha kërkuar sinqerisht nga ai, që me përdorë dhe me bë lajm Komunën e Fushë-Kosovës sot, sepse nuk i kan kaluar normat e arsimit subjektet politike dhe nuk kan votuar për. Kisha dashur me i falënderuar kolegët e mi të Lidhjes Demokratike të Kosovës edhe partnerëve te cilët ju kanë përgjigj ftesës dhe përgjigjen në secilin moment kur ka rëndësi të veçantë, ne kemi anëtar të grupit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, i cili ka lënë të pame të hapur në shtëpi, vetëm për të marrë pjesë dhe për ti kaluar këto pika. Ndërsa ju sot jeni prezentë dhe nuk merrni pjesë në votim, kisha pas dëshirë ta di se si ndjeheni, kur me 1 shtator edhe në arsim edhe në shëndetësi gjasat janë me pas përkeqësim për arsye të mungesës së stafit adekuat. Unë dhe stafi im te cilët votuam, jemi të qetë me veten tonë, jemi të pastër para atyre punëtorëve, para nxënësve dhe para pacientëve. Ne japim shërbime për mbi 70.000.00 banorë, stafi ofron shërbime në mënyrën më të mirë të mundshme. Ne duhet me i lut punëtorët që të vinë dhe të punojnë në mënyrë vullnetare, sepse nuk kanë kaluar 43 norma në shëndetësi. Kolegë ju ftojë, që të merrni pjesë në votim, mos te bëhemi pjesë e inateve politike dhe nuk bënë me u merr kush e ka bërë propozimin.

Durim Hajra: Kush do qysh do, mundet me keqpërdorë, me dalë në foltore dhe me shit moral, por realiteti është ky, besoj se kush ka qenë prezent në mbledhjen e kaluar, ka pas fatin me dëgjuar fjalimin tim, unë po i drejtohem kolegut timë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, i nderuar kolegë, sa i përket mbarëvajtjes së punës së Kuvendit, mbledhjes së fundit, që sot po vazhdon edhe ju për me qen korrekt me opinionin duhet me tregu saktë prej kur ka fillua mbledhja, si ka vazhduar dhe si është ndërprerë dhe si është thirrur sot për me vazhduar, në mbledhjen e kaluar në mungesë të numrave, e që jeni të thirrur ju me i bë numrat, e qe nganjëherë edhe opozita u' a ka votuar, ju mundeni mu treguar i pasinqertë në raport me neve dhe në raport me te gjithë qytetarët, ju po thuani që opozita sot, po bllokton për inate politike dhe nuk qëndron kjo. Ne i kemi votuar normat në arsim edhe në shëndetësi kur ka qenë nevoja, mirëpo jo në pafundësi, kemi dal në këtë foltore dhe kemi thënë gjeni zgjidhje afatgjate, ju i keni zgjedh metodën më të lehtë për me kthye këtë

punësim në votën klienteliste dhe del sot na mban moral se si duhet përmisuar gjendjen në arsim, ne jemi duke qeverisur që një zet vite dhe faji është i opozitës, kjo është shumë e ulët dhe është keqpërdorim i foltores dhe korrektësisë së asamblistëve dhe kolegëve në këtë Kuvend. Mbledhja është ndërprerë për fajin e juaj, nëse ka qenë urgjente kjo pikë e rendit të ditës me kalua, ju është dashur me bërë të pamundurën dhe me këmbëngulë, e me na mbajt neve në mbledhje të Kuvendit, e jo me lëshuar mbledhjen vetë dhe me këqyr me i bërë votat, mirëpo jo me këqyr në forma klandestine, me këqyr me ble ndonjë asamblistë, me ndonjë punësim apo diçka he me ardh me na shit moral pse ne sot nuk po i votojmë, sepse nuk është hera e parë në këtë kuvend komunal, kur nuk i a votat mazhuranca dhe kjo është shumë normale, por jo me dal dhe me na shit moral në mbledhje. Qytetarët janë të njoftuar, sepse me at sa kemi pasur mundësi jemi munduar me i informuar. Për hire të një praktike të mirë, të cilën e kemi bërë, për dallim nga te gjitha Kuvendet Komunale, ju kemi ardhur edhe dje në takim edhe pse nuk e keni merituar realisht, as në takim me ju ardh. Ju keni ardh në takim, me qëllimin që kur të doni ju me thirrë. Të gjitha subjektet politike kanë qen te dakorduara te mbahet mbledhja të enjten, jo sot, çfar bashkëpunimi është ky dhe pse pe paragjykoni vendimin tonë, ndoshta na seancën e fundit te cilën ju e lëshuat e kishim votuar këtë pikë të rendit të ditës, pse po paragjykoni, sepse ne vitin e kaluar e kemi votuar, por ju jeni duke u frikësuar se mos po ju ik merita e jeni në kohë fushate, nuk mundesh me thënë nuk kemi hapsir në shkolla, kemi problem me norma është, sepse faji pikërisht është i Lidhjes Demokratike të Kosovës. Para tet viteve kam dal në foltore dhe kam thënë, marrëveshja me caritasin është e kundërligjshme, nuk është mirë dhe duhet me gjet zgjidhje, tet vite kanë kaluare. Tet vite nuk ka ndermumar asnjë hap, për me gjet zgjidhje afatgjate. Ne sot Grupi i Lëvizjes Vetëvendosje, jemi vetëm tre për arsye të angazhimeve që i kanë pas të tjerët asamblistë. Unë mendoj se është e papranueshme me dal dhe me hedh akuza, sepse ne vazhdimisht kemi kërkuar me gjet zgjidhje afatgjate, për mos me lënë fushën e arsimit dhe shëndetësisë, në këtë formë që është. Por ju jeni kohë fushate dhe bëne zgjidhjen vetë, sepse me duket e pa pranueshme me kërkuar shpëtim nga ne, sepse po e dini edhe vet që i ka ardhur fundi Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Laureat Gojnovci: Nuk e di kolegu nga Lëvizja Vetëvendosje jeton në Kosovë, apo në vende skandinave dikund, me thënë eja bëjmë zgjidhje afatgjate për normat, në arsim dhe shëndetësi është absurde. Unë po e shoh Drejtorin e Arsimit, po ashtu Drejtorin e Shëndetësisë, i cili e ka pranuar me herët mandatin, le të deklarohen drejtorët sa shkresa i ka dërguar, ministrisë së arsimit, për me ju lejuar normat e reja në Komunën e Fushë-Kosovës. Çka duhet me bë komuna e Fushë Kosovës për zgjidhje afatgjate, ka ndodh shtimi i popullsisë, mundemi mu akuzua që Lidhjes Demokratike të Kosovës, ka qen në nivel nacional, po ka qenë, por nuk ka qenë e nevojshme sa është tash, kërkesa për norma të reja në arsim, kjo ministri cila nuk ka reflektuar, deri tek njoftimi zyrtar, ministria ka filluar me ndërtuar çerdhe, pa i pasur normat, nuk thash që nuk ka hapësirë Komuna e Fushë-Kosovës, me qato mjete çka i kemi në dispozicion vazhdon me ndërtua çerdhe, shkolla, por ne nuk kemi norma i nderuar, ne duhet me marr prap vendim, e që shpresoj se do ti dalim mi bë këto norma.

Durim Hajra: Nuk qëndron ajo e cila e tha kelogu më herët, ministria e Arsimit dhe Ministria e Shëndetësisë, e kanë kryer punën e vetë, flas për Ministrat te cilët janë në kohën e fundit. Kanë rastis me qenë të Vetëvendosjes, ka rastis që ai i vetëvendosjes me pas vullnetin politik, kundër atyre të Lidhjes Demokratike të Kosovës, te cilët kanë qenë më herët, jemi dëshmitar që edhe akter të Lidhjes Demokratike të Kosovës, kanë marrë merita, me normat e viteve të kaluara te cilat, kanë

qenë mbi 160 norma, por edhe me norma të reja në shëndetësi, por edhe me katër çerdhe që i ka ofruar ministria, e nuk keni gjetur tokë. Një shkollë të cilën e' ka propozuar Ministria, e ke ndërtuar në oborrin e shkollës Selman Riza', sepse nuk ke pasur hapësirë, e ke pronën publike në Nakarad, te cilën nuk guxon me lëvizë, prej atyre, 20 ari i ka blerë komuna e Fushë Kosovës, shko ndërto ku e ke blerë pronën dhe ju kisha lutur mos me shit moral dhe mos mem ndërhy gjatë fjalimit time, prej vendit. Ndërsa sa i përket bashkëpunimit me Ministri, ky kryetar Komune, i ministrit Arben Vitia, kur ne i kemi bërë presion shkruaj ministrit e-mail zyrtar, ti bëjmë presion bashkërisht, e ku me doktor z. Remzi Shala i kemi bërë, i kemi dërguar shkresë Ministrisë së Shëndetësisë, ku i kemi kërkuar zgjidhje për normat në shëndetësi, në mënyrë unanimiteti kemi votuar në këtë Kuvend Komunal, mi bër presion ministrit të vetëvendosjes, shkresa e vetme e cila i ka shkruar Ministrit z.Arben Vitisë, te cilin e kam thënë edhe në opinion, në debat të RTK-së, prej Kryetarit të Komunës ka qenë, I nderuar Ministër, gjej mundësinë në konkursin e radhës, gjej hapësirë për x-punëtorin këtu, kjo ka qenë shkresa. Nuk ka qenë shkresa për Pediatër dhe Gjinekologë, ky është niveli i shkresës te cilat kanë shkruar.

Hasan Ismajli: Kolegu më herët në mungesë te votave, një mal me akuza e hedhi tek ne. I nderuari z. Laureat Gojnovci, askush nuk ja dinë rëndësinë më shumë se unë arsimit dhe shëndetësisë, po them shëndetësi, sepse kam pasur raste familjare dhe nga aspekti opozitar, duke i hedhur një mal akuza nga Kryetari i Komunës, ku çdo takim që ka pasur më ka bullizuar me lloj lloj fjalësh, unë këtu kam deklaruar se kur kemi të bëjmë me arsim dhe shëndetësi, un nuk jam opozitë, jam vetëm banorë i Komunës së Fushë-Kosovës dhe nuk nij, por kur janë kaq imediate këto norma, i kuptoj barabartë me ty, sepse çdo dit jam në qendër, Kryetari i Komunës nuk e sheh të arsyeshme, mi thirr përfaqësuesit e subjekteve politike dhe mu ul në tavolinë me ta dhe me gjete një zgjidhje. Jeni ardhur këtu, duke na sulmuar neve, sepse ne kemi me qenë fajtorë, për normat e arsimit, jo ne nuk kemi me qenë fajtorë, sepse un me votën time nuk votoj, me ardhur dikush nga Prizereni dhe me u punësua në Komunën e Fushë-Kosovës, ndërsa banorët e komunës sonë mi neglizhuar dhe ju e dini këtë rast me mirë se unë. Drejtori i Arsimit nga atje thotë nuk është e vërtetë, Aneksi te QMF-ja është i ndërtuar në pronë të AKP-së, nuk ka leje ndërtimore fare. Kryesues dje kemi ardhur në takimin te cilin na ke ftuar dhe e dimë mirë se si jemi dakorduar, ku kemi propozuar mos me mbajt seancë të mërkurën, përfundon takimi dhe në ora 15:10 minuta vjen mesazhi ku thirremi për seancë për të mërkurën, pyes pse e thirrni seancën kur nuk i keni votat?

Fisnik Sllamniku: Dua ta sqaroj çështjen e normave, nuk mundet mu bërë planifikimi, për arsye se prej vitit 2011, nuk ka pasur regjistrim të popullsisë, dhe për këtë arsye nuk kemi mundur me planifikuar norma as në arsim as në shëndetësi, vendimet kur i keni marrur këtu i kemi marr kundërligjshëm, për favor të nxënësve, sepse në shtator është dashur me fillua procesi arsimor. Numërimi i popullsisë u bë dhe tash jemi duke planifikuar për vitin 2026, falënderoj drejtorin e shëndetësisë për sqarimin, sepse na laboroj shumë mirë. I falënderoj edhe stafin arsimor, sepse kanë zëvendësuar pa pagesë, vetëm mos me i lënë mbrapa nxënësit. Unë mendoj se kjo pik duhet me u përkrahë.

Vlonjat Hasani: Kjo praktik nuk është e mirë nga ana e ekzekutivit, sepse transparencë në këto raste nuk ka fare. Me 30 qershor ditën e hënë, kanë qenë këto pika të rendit të ditës të njëjta, për normat në arsim dhe në shëndetësi. Ju kisha lutur me më respektuar dhe mos me më penguar, kur jam duke folur, sepse unë nuk ja ndërpreva fjalën askujt. Shefi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, ka dal këtu dhe ka treguar pse duhet me lëshuar seancën, e lëshuan

seancën dhe për çudi shefi ka shkuar në zyrën e Kryetarit dhe ka nejt aty, ju vet jeni mashtrues sepse ju vet e lëshuat seancën. Sot del në votim pika e rendit të ditës, askush nuk merr pjesë në votim, kërkon edhe një herë mu kthyer me votuar, i merr 10 vota dhe thotë hajde tash te shohim kush ka drejtë, nëse e shikojmë ligjërisht, herën e parë ka hedh në votim dhe nuk ka marr asnjë votë dhe momentin që nuk merr asnjë votë, ajo pikë nuk kalon, tash nëse doni me qenë të sinqertë pranone.

Laureat Gojnovci: Nuk është në rregull fjalori te cilin e përdore.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ju lutem qetësohuni, përndryshe do ta ndërprej seancën për arsye të z. Laureat Gojnovci dhe z. Mirsad Qyqalla.

Drejtori i Shëndetësisë-Hysen Sllamniku: Këto norma janë për vitin 2026, për një zgjedhje afatgjate, bazuar në regjistrimin e popullsisë, bazuar në grandin specifik, të propozuar nga Ministria e Shëndetësisë, neve na takojnë edhe 43 norma të reja për vitin 2026. Ministria e Shëndetësisë ka qenë shumë e sinqertë, ku është habitur me ministrin e financave, pse nuk ju kanë pranuar normat.

Durim Hajra: Problemi është se janë keqpërdorur normat e arsimit dhe normat e shëndetësisë.

Laureat Gojnovci: Unë nuk dua me u merr me lloj lloj njerëzish, por dua nga ju si Kryesues i Kuvendit të Komunës, para çdo votimi ta konstatoji numrin, po ashtu edhe zyrtari i cili mban procesverbalin, pas konstatimit të kuorumit, me treguar sa asamblistë, kanë marr pjesë në votim, sepse ne do të kërkojmë interpretim.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Në rregull i nderuar, tash jemi 18 asamblistë prezentë. Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim, 'Propozimin për lejimin mjeteve financiare për norma të reja në shëndetësi për vitin shkollor 2026' rendin e ditës për mbledhjen e sotme.

U votua me: trembëdhjetë vota për, kundër nuk ka dhe asnjë abstenim, gjithsej tetëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Kuvendit të Komunës me shumicë të votave, e aprovoi 'Propozimin për lejimin mjeteve financiare për norma të reja në arsim për vitin shkollor 2025-2026' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e Kërkesës Nr. 627, të datës 17.06.2025, për shpalljen e vendeve të reja të punës dhe lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 367,144.80€, për punësimin e punëtorëve shëndetësorë dhe nëpunës administrativ dhe mbështetës, në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi', në Fushë-Kosovë në vitin 2026, përmes procedurës së hapur të konkurimit publikë.
2. Paga për secilin të punësuar do të realizohet sipas Ligjit për Pagat e Sektorit Publik në fushën e shëndetësisë për vitin 2026, si në Propozimin me Nr. 627, të datës 17.06.2025.
3. Numri dhe pozitat e punëtorëve shëndetësorë dhe nëpunës administrativ dhe mbështetës, për përmbushjen e nevojave të operimit dhe funksionimit të institucioneve shëndetësore në Komunën e Fushë-Kosovës është si vijon:

3.1 Gjashtë (6) mjekë të përgjithshëm;

3.2 Një (1) mjekë stomatolog;

3.3 Tetëmbëdhjetë (18) infermiere të përgjithshme;

- 3.4 Katër (4) teknikë të stomatologjisë;
- 3.5 Katër (4) Teknik Laborant;
- 3.6 Një (1) Teknik të Farmacisë;
- 3.7 Dy (2) Vozitës;
- 3.8 Tre (3) Hixhenistë
- 3.9 Një (1) Administrator i Sistemit Informativ Shëndetësorë;
- 3.10 Një (1) Mirëmbajtës Punëtorë Teknik;
- 3.11 Një (1) Punëtorë i Sigurimit dhe
- 3.12 Një (1) Jurist.

Pika e shtatë (7): Informatë e Drejtorisë së Arsimit për ndarjen e bursave për studentët e Komunës së Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ftoj Drejtorin e Arsimit të ma sqaroj pikën e rendit të ditës.

Drejtori i Arsimit: Së pari dua ta sqaroj se me vite, kemi dërguar shkresa zyrtare në ministrinë e financave, Ministrinë e Arsimit dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës, me 19.11.2012, është shkresa e parë, shkresa e dytë me 05.07.2015, shkresa e tretë 14.09.2016, shkresa e katërt 18.07.2018, 12.09.2017, 20.11.2017, 22.01.2018, po ashtu në vitin 2021, në vitin 2022 nuk kemi shkresë sepse i kemi fituar 152 norma, në vitin 2023 prap kemi dërguar shkresë, 2024 prapë dhe me 17.06.2025 kemi shkruar prap dhe kjo shkresë është e bazuar, jo në kërkesat e Drejtorisë së Arsimit, por në kërkesën të cilën e ka bërë Ministria e Arsimit, sa i përket numrit të përgjithshëm të nxënësve. Prej viti 2012 janë shkresat të cilat vazhdimisht kemi kërkuar. Sa i përket informatës së Drejtorisë së Arsimit, kanë përfituar 854 persona, nga ta janë, 461 student bachelor, 113 master, 70 fëmijë me nevoja të veçanta, 200 nënës të cilëve ju ka paguar transporti dhe dhjetë botime letrare. Ju premtoj se deri në mbledhjen e radhës, do të publikoj të gjithë emrat e përfituesve, në web faqen e Komunës së Fushë-Kosovës.

Bashkim Krasniqi: Mesa kam unë njohuri, pika e cila i pat 13 vota kalon, por ndoshta me mirë kishte qenë, me kërkuar interpretim ligjor në Ministri.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Me ligj duhet Kryesuesi i Kuvendit me konstatuar, unë konstatova dhe ai që mendon ndryshe vazhdon procedurat ligjore.

Pika e tetë (8): Kërkesë për rishqyrtimin e vendimit Nr.47 sipas shkrësës 020-327/6, të datës 13.06.2025, lidhur me fillimin e procedurave për revidimin e Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ky vendim na u ka kthyer nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, a' don me marr fjalën dikush.

Drejtori i Urbanizmit: Lidhur me vendimin me Nr.47, në bazë të propozimit të Drejtorisë së Planifikimit Urban, për plotësim ndryshimin e Hartës Zonale, është kthyer rishqyrtimi i ligjshmërisë së aktit, me disa kërkesa specifike, për plotësim ndryshim të vendimit, unë e kam plotësuar lëndën me raportet, e zbatimit dhe monitorimit të Hartës Zonale, për me plotësuar kushtin të cilin kërkohet, sipas ligjit për Planifikim Hapësinorë, për të dëshmuar se Harta Zonale mbetet në zbatim nën 40% edhe pse kjo pas konstatimit të Ministrisë si arsye shtesë është harmonizimi me planin zhvillimor komunal, në pjesën e fundit të këtij akti të rishqyrtimit e kemi edhe

inkuadrimin e Ministrisë, që i jep Komunës së Fushë-Kosovës që sa më parë, ta përfundon procesin e hartimit, të planit zhvillimor komunal, në mënyrë që harta zonale të jetë në harmoni, vazhdimisht e kam potencuar që kjo është edhe kërkesa edhe arsye themelore, që mos të kemi diskrepancë të dy planeve hapësinore. Kërkoj nga ju që ta bëni plotësim-ndryshimin e këtij vendimi, në mënyrë që ta marrim një aprovim nga Ministria, për fillimin e procedurave dhe pastaj ashtu siç e kemi sqaruar në mbledhjet e tjera të kuvendit, eventualisht fillojmë procesin për revidim ose plotësim-ndryshim të hartës zonale.

Laureat Gojnovci: Kërkoj jashtë pikës së rendit të ditës, sa i përket procedurës, për interpretim nga Zyrtari Ligjorë, për nenin 48 pika 2, që thotë nëse ndryshe nuk parashihet shprehimisht në këtë ligje, vendimet e Kuvendit të Komunave, aprovohen me shumicën e anëtarëve që janë të pranishëm dhe votojnë në mbledhje. Po ashtu kërkoj pastaj nga ministria. Kemi rastin e Komunës së Prishtinës, ku opozita nuk ja mundëson kuorumin, para se me hy në votim, në mënyrën kur hyn në votim, ata nuk janë prezentë në sallë edhe nuk garanton kuorum të anëtarëve, shumicës që janë pjesëmarrës, deri tash në Kuvend ka më dhjetëra mendime, për arsye të ndryshme, që është e natyrshme, sepse si ekzekutiv nuk kemi pasur, nuk kemi mundur të sigurojmë numrat, për arsye të ndryshme. I nderuari z. Hasan, tu kisha lutur me marr fjalën dhe me na interpretuar, qysh ju e vlerësoni nenin 48 pika 2.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Unë nuk ja jap z. Hasan Gjyrevci fjalën dhe mu kthyer mbrapa, unë jam tek pika e rendit të ditës, ku Ministria e ka kthyer vendimin dhe nëse ka dikush diçka sa i përket rendit të ditës, urdhëroni merne fjalën.

Hasan Ismajli: Nëse është kështu siç po thotë kolegu, mua më konvenon, sepse një propozim të cilin unë e kam propozuar për një ndihmë financiare për shërim, në shumën e mjetëve prej 5000€, i kam pas vetëm 13 vota dhe pjesën tjetër nuk e kam pas, unë kërkoj edhe atë. Ndërsa sa i përket pikës së radhës së rendit të ditës, drejtor na kanë ardhur dy pika tuat. Pika për fillimin e procedurave për debat publik, për Planin Zhvillimor Komunal, me na treguar sepse nuk ka sens këto dy pika të cilat i ke sjell më herët, me fillu revidimin e hartës zonale, kur ju menjëherë pikën tjetër e keni Planin Zhvillimor Komunal dhe Revidimi i Hartës Zonale nuk shkon, pa Plan Zhvillimor Komunal dhe e ki tek pika tjetër që është tek Uglari, ku ministria ta ka kthyer që duhet të bëhet në përputhje me Planin Zhvillimor Komunal dhe me hartën zonale dhe asnjëra atje nuk i ka paraparë, sepse planin zhvillimor komunal nuk e ke më, e në çoftë se e ki të lutem sjell na dhe unë kam me qëndruar pas teje. E ke sjell menjëherë pikën tjetër një muaj më vonë, ka ardh pika për planin Zhvillimor Komunal, a një muaj përpara e ke sjell revidimin e hartës zonale, unë mendoj se nuk revidohet harta zonale, sepse ka shumë punë para se me ardhur tek revidimi dhe ju nuk e keni kryer asnjë. Kur të dalësh këtu je i thirrur, me të shpjeguar ashtu siç i ke mësuar dhe i din, jo për hire të politikave, që dikujt i konvenon.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Një pyetje kam për ju i nderuar drejtorë, a' ki kërkesë për me ndryshuar-plotësua këtë vendim diçka, apo unë po e hedh në votim, për ta shfuqizuar këtë vendim të cilin e kemi marrë si Kuvend.

Drejtori i Planifikimit Urban: Po filloj me përgjigjet të kolegut z. Hasan Gjyrevci, sepse dua që ta sqaroj njëherë e përgjithmonë, Fushë-Kosova ka Plan Zhvillimor Komunal, kjo argumentohet edhe me aktin për rishqyrtim, të hartimit të planit rregullativ, ku Ministria thotë vendimi duhet të ketë bazë ligjore, me planet hapësinore në fuqi, pjesë e vendimit duhet të jetë ekstrakti, ku është dhënë rekomandimi për Planin Zhvillimor Komunal aktual, sepse ajo është në fuqi, deri sa të

aprovohet i riu, pa marr parasysh që ju po konstatojmë që ka skaduar afati, unë e kam bashkangjitur ekstraktin prej Planit Zhvillimor Komunal, ku ipet rekomandim, për hartimin e planeve rregullative të hollësishme, është direktivë është faqe 75, ku përshkruhet procedura, e kam bashkangjitur edhe ekstraktin në hartën zonale, faqe 217, ku po ashtu ipet rekomandim, sepse janë vetëm dy plane hapësinore, me të cilat Komuna e Fushë-Kosovës, operon dhe plani hapësinor i hollësishëm, bënë për secilën zonë kadastrale edhe ne kemi bërë propozim, për hartimin e tij një pjesë të zonës urbane, qysh parashihet edhe në ekstrakt, nuk e kam shkruar unë, po është e shkruar në Plan Zhvillimor Komunal, kështu që dilemën se a ka Fushë Kosova Plan Zhvillimor Komunal apo s'ka, un them që ka sepse me parimin e dispozitës kalimtare, deri sa të aprovohet i riu, i vjetri mbetet në fuqi edhe masë skadimit komuna mundet me vazhduar dhe me punuar, sepse ti nuk mundesh me paraparë, që plani hapësinorë e ka një vlefshmëri vetëm tet vite, ai e ka një vlefshmëri prej tet viteve, deri sa të aprovohet i riu mundet me shku 9,10,11 vite e tutje. Kërkesa ime është, që ky plotësim-ndryshim, nuk ka të bëjë me shfuqizim dhe nuk është revidim, por është termi që është përdorur në propozim atje, mendoj se është dashur me qen i saktë ky plotësim-ndryshim. Raportet e zbatimit të monitorimit janë, pseja e hartografike dhe tekstuale, prej Drejtorisë së Planifikimit Urban, nuk mundeni me kërkuar, sepse unë nuk jam, në cilësinë e hartuesit, unë jam duke kërkuar një fillim të procedurave edhe konstatimin që është kthyer, e dëshmon se nuk qenka ashtu siç është proklamuar, herën e kaluar që është proces i kundërligjshëm, pra është shumë i ligjshëm dhe është e drejtë ligjore e Komunës, Komuna është autoriteti përgjegjës komunal, këtë rast drejtoria e përgatit propozimin, por janë kërkuar plotësime dhe nëse janë kërkuar këto plotësime, ato janë pjesë e bashkangjitur, me propozimin për plotësim ndryshim.

Hasan Ismajli: Nëse kalon pika për planin zhvillimor komunal të riun dhe ky plan zhvillimor komunal ka gjasa, me u aprovua para se me bë këtë plotësim-ndryshimin e hartës zonale, qysh ki mi përputh këto.

Drejtori i Planifikimit Urban: Unë jam duke bërë, fillim procedurës, komuna masa ndej, e ka për obligim me shpall procedurat tenderuese, me i qit kriteret, deri sa të fitohet, kjo ngutia që juve po ju duket, ta keni parasysh që për vlerësimin strategjik mjedisor komuna e Fushë Kosovës, për një aprovim ka pritë tetë muaj edhe në plan zhvillimor tash te cilin e kam bërë për me dal në shqyrtim publik, janë prej marsit në procedurë edhe këto procedura nuk shkojnë ashtu të thjeshta dhe ministrisë nuk i ngutet dhe nuk merr parasysh m çfarë probleme merret drejtoria e planifikimit urban dhe unë e kam bërë vetëm kërkesën për fillim të procedurave.

Durim Hajra: Një gjë që un ju kam referuar në të kaluarën, mendoj se e ke keqkuptuar, ne e kemi kundërshtuar iniciimin e procedurës për ndryshim të hartës zonale, ka qenë pikërisht baza ligjore, nuk kemi kërkuar nga drejtoria decidivisht për një parcelë, ose për një zon të caktuar se harta çka ka me pas të përfshimë, këtë e ka thënë rregullorja dhe baza ligjore te cilës ju keni referuar ju, ne jurista nuk jemi, ju kemi thënë edhe atëherë, po e përsërisim edhe tash, nëse një bazë ligjore te cilës ju keni referuar ju, kur e keni prurë propozimin për plotësim ndryshimin, e kemi marrë e kemi shqyrtuar, e kemi pa që aty kërkohet që në zona të caktuara duhet me qen pjesa hartografike e prezantuar, aty ku kanë me qenë ndryshimet, ato te cilat kemi kërkuar ne i ka kërkuar edhe ministria, unë për me qenë korrekt, kemi thënë a e kemi një Plan Zhvillimor Komunal në fuqi, sjelle ta shohim se çka parasheh, sepse ti po e paragjykon epilogun e kompanisë të Planit Zhvillimor Komunal të riun me procedura për plotësim ndryshimin, nëse plani zhvillimor

komunal i riu parasheh diçka më të mirë, pse po donë me plotësua-ndryshua hartën zonale, sepse ndoshta prap do duhet me plotësua ndryshua.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ministria e ka kthyer vendimin dhe ka thënë rishqyrtoni dhe ka kërkuar raportin e monitorimit, të zbatimit të cilin e kemi kërkuar, Drejtori i Planifikimit Urban e ka sjell këtë raport dhe po kërkon me bë plotësim-ndryshim e vendimit mbi bazën e këtij raporti.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Konstatoj se gjithsej janë 17 anëtar prezent në mbledhje.

Durim Hajra: Këtu je duke përdorur standart të dyfishtë, sepse qysh në fillim të këtij mandati kemi kërkuar edhe unë dhe z. Hasan Ismajli, para secilit votim të shkruhet emri në procesverbal, kurrë nuk e keni bërë evidentimin.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim, 'Propozimin për lejimin mjeteve financiare për norma të reja në shëndetësi për vitin shkollor 2026' rendin e ditës për mbledhjen e sotme.

U votua me: trembëdhjetë vota për, kundër nuk ka dhe asnjë abstenim, gjithsej tetëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Vendimi të cilin e kemi marrë është ende në fuqi, për arsye të mungesës së votave. Meqense atë që kërkuat ju drejtor nuk kaloi, unë e qes vendimin me shfuqizuar, sepse nuk lë unë vendime në fuqi.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim, 'Kërkesë për rishqyrtimin e vendimit Nr.47 sipas shkresës 020-327/6, të datës 13.06.2025, lidhur me fillimin e procedurave për revidimin e Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës.

U votua me: pesë vota për, kundër nuk ka dhe asnjë abstenim, gjithsej shtatëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Kuvendit të Komunës e lan në fuqi vendimin.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim, 'Kërkesë për rishqyrtimin e vendimit Nr.47 sipas shkresës 020-327/6, të datës 13.06.2025, lidhur me fillimin e procedurave për revidimin e Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës.

U votua me: trembëdhjetë vota për, kundër nuk ka dhe asnjë abstenim, gjithsej tetëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

V E N D I M

1. Aprovohet ndryshim - plotësimi për fillimin e revidimit të Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2020-2028, në përputhje me raportet për zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës për vitet 2021, 2022, 2023 dhe 2024 të Drejtorisë së Planifikimit Urban.

Pika e nëntë (9): Kërkesë për rishqyrtimin e vendimit Nr. 48 sipas shkresës 020-327/7, të datës 13.06.2025, lidhur me fillimin e procedurave për Planin Rregullues të Hollësishëm të Fushë-Kosovës

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ministria e ka kthyer dhe ka sqaruar që është një lëshim teknik në bazën ligjore, besoj se drejtori ka me kërkuar me përmissuar atë, por ka me kërkuar edhe diçka tjetër.

Drejtori i Planifikimit Urban: Njëjtë edhe për vendimin 48, bazuar në propozimin e Drejtorisë së Planifikimit Urban, kërkoj plotësim ndryshimin, në pikat e kërkuara nga Ministria, te arsyetimi është kërkuar që pjesë e vendimit, duhet të jetë ekstrakti, ku veç e kam potencuar edhe më herët, të dy planeve hapësinore, kërkoj mos te ngatërrohet fushëveprimi i planit zhvillimor komunal, që quhet Harta Zonale Komunale dhe Plani Rregullativ i Hollësishëm, për zona të veçanta, këto janë plane hapësinore, te cilat ne zbatojmë direktiva të ndryshme ka strategji të ndryshme, për drejtorin është jetike që me pas vlera të përcaktuara, për me mundur me funksionuar normalisht, këtu është konstatuar se në preambulë ka pasur disa gabime teknike, te cilat i konsideroj se zyra ligjore, mundet lehtë mi përmirësuar, për shkak se në propozim kanë qenë të përshkruara saktë, kështu që kërkoj të përshkruhen ashtu siç kanë qenë në propozim dhe besoj se me plotësimet te cilat janë bërë përmbushet kërkesa e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim, **'Kërkesë për rishqyrtimin e vendimit Nr. 48 sipas shkresës 020-327/7, të datës 13.06.2025, lidhur me fillimin e procedurave për Planin Rregullues të Hollësishëm të Fushë-Kosovës'**

U votua me: trembëdhjetë vota për , kundër nuk ka dhe asnjë abstenim, gjithsej tetëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Kuvendit të Komunës se nuk kalon si pikë e rendit të ditës, për arsye të mungesës së votave

Në bazë të votimit aprovet propozimi lidhur **me fillimin e procedurave për Planin Rregullues të Hollësishëm të Fushë-Kosovës.**

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim,

U votua me: trembëdhjetë vota për , kundër nuk ka dhe asnjë abstenim, gjithsej tetëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

V E N D I M

Për aprovimin e Propozimit me Nr. 471 të datës 13.05.2025 për fillimin e procedurës për hartimin e Planit Rregullues për Zonën Urbane të Fushë-Kosovës

Për aprovimin e Propozimit me Nr.471, të datës 13.05.2025 për fillimin e procedurës për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për pjesën e zonës urbane të Fushë-Kosovës, që përfshinë ngastrat kadastrale në mes të rrugës 'Gjergj Fishta' dhe rrugës së 'Uglarit' për bloqet e banimit: E5, E6, E7, E18, E19, E20 dhe E21, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Planifikimin Hapësinorë Nr. 04/L-174 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2018 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme.

Pika e dhjetë (10): Propoziti vendimi për hapjen e shqyrtimit publik për Planin Zhvillimor Komunal 'Fushë-Kosovë 2025-2033'

Drejtori i Planifikimit Urban: Kemi një propozim për 'Hapja e dëgjimit publik për Planin Zhvillimor Komunal Fushë-Kosovë 2025-2033' për një periudhë tet vjeçare, ne e kemi draftin final të gatshëm, për prezantim para publikut, kërkoj që ta mbështesni votimin e këtij plani në mënyrë që të fillojmë me procedurën e shqyrtimit publik, për një periudhë 30 ditore, si obligim ligjor i drejtorisë është që pas marrjes së vendimit, për një periudhë prej tet ditëve të bëhet njoftimi dhe pastaj të fillojmë me prezantimin e draftit, në formë digjitale në web faqen e komunës, po ashtu edhe në formë fizike, në objektin e Komunës së Fushë-Kosovës, për shkak të vëllimit të madhe dhe pamundësisë që me bashkëngjit draftin, drafti do të jetë i qasshëm në, web faqen komunale, besoj se Zyrtari përgjegjës e kryen si procedurë.

Laureat Gojnovci: Përpara kemi një propozim nga Drejtoria e Planifikimit Urban, ky është dokumenti më i rëndësishëm komunal për Komunën e Fushë-Kosovës, ky është obligim ligjor që me bë hapjen e procedurës, për ti vazhduar procedurat e përpilimit të këtij Planit Zhvillimor Komunal, besoj secili nga ne do të ketë mundësi, me zgjedh a me votuar apo jo, ne e përkrahim dhe do ta dhëjmë kontributin tonë.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim, 'Propozim-vendimi për hapjen e shqyrtimit publik për Planin Zhvillimor Komunal 'Fushë-Kosovë 2025-2033'.

U votua me: trembëdhjetë vota për , kundër nuk ka dhe asnjë abstenim, gjithsej nëntëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Kuvendit të Komunës se nuk kalon si pikë e rendit të ditës, për arsye të mungesës së votave.

V E N D I M

Për shqyrtimin publike të 'Projektit-Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Fushë-Kosovës 2025-2033'

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 948, të datës 19.06.2025, me të cilin shpallet në shqyrtim publik 'Projekt-Planin Zhvillimor Komunal i Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2025-2033'.
2. Hapja zyrtare e shqyrtimit publik me pjesën tekstuale dhe grafike dhe prezantimi i 'Projekt-Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2025-2033', bëhet në sallën e Kuvendit të Komunës dhe zgjat në afat prej 30 ditëve.
3. Projekt-Planit Zhvillimor Komunal i Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2025-2033, i nënshtrohet vërejtjeve, komenteve dhe sugjerimeve të publikut para përfundimit, të gjitha vërejtjet, komentet dhe sugjerimet që paraqiten nga publiku me goje gjatë diskutimeve, me shkrim në librin e vërejtjeve apo përmes adresës elektronike, brenda afatit kohor të përcaktuar, përfshihen në raportin mbi shqyrtimin publik.

Pika e njëmbëdhjetë (11): Propozim për lirim nga pagesa banorët e tri komunave të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanovcit.

Hasan Ismajli: Unë e kam propozuar lirim nga pagesa për banorët e tri komunave të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanovcit, te cilët janë në proces të pritjes së dokumenteve, për të qenë banorë rezident të Komunës së Fushë-Kosovës dhe ta marrin shtetësinë e Republikës së Kosovës. Unë e

kam lexuar edhe Udhëzimin Administrativ, ku thotë të gjithë ata banorë, që janë në pritje të dokumentit, lirohen nga taksa prej 5€, unë kam marr sqarim edhe nga zyra e ofiqarisë dhe kam thënë kur banorët e këtyre tri komunave kur të vijnë me bë kërkesë dhe i dorëzojnë dokumentet te cilat kërkohen, a marrin ndonjë dokument këta qytetar që i kanë dorëzuar dokumentet dhe zyra e ofiqaris më ka thënë po, të gjithë këta pajisen me një dokument.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Nëse ne e marrim një vendim si Kuvend, ambulanta nuk i pranon, pa marr një dokument nga gjendja civile dhe aj besoj se nuk mundet me marr dokument nga gjendja civile dhe ky vendim nuk e di a' ka me qen ligjërish i vlefshëm dhe a krijon mundësi, unë po e kuptoj vullnetin tënd.

Hasan Ismajli: Kjo nuk është as vullnet e as dëshirë e imja, sepse un jam banorë i vjetër këtu. Por nuk di sa me kuptuat, un thash para se me ardh këtu e kam sqaruar këtë propozim me zyrën e ofiqarisë, sepse në Udhëzim thotë të gjithë ata që janë në pritje të dokumentit dhe ata te cilët janë në pritje kanë një dokument dëshmi që kanë dorzuar në ofiqari.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim, 'Propozim për lirimin nga pagesa banorët e tri komunave të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanovcit.

U votua me: shtatë vota për , kundër nuk ka dhe asnjë abstenim, gjithsej tetëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Kuvendit të Komunës se nuk kalon si pikë e rendit të ditës, për arsye të mungesës së votave.

Pika e dymbëdhjetë (12): Të ndryshme.

Bashkim Krasniqi: Kërkoj që të plotësohet Komiteti për Komunitete, me anëtarin z. Qerim Gara në vend të z. Artan Asllani, i cili tash ka kaluar në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Vlonjat Hasani: Kryesues në fillim të seancës, ju kam drejtuar për një kërkesë të një bashkëvendësit tonë, i cili me një kërkesë ju ka drejtuar Kuvendit për ndihmë në shëndetësi, qytetari ka dashur ta di ku ka shkuar me procedurë, kërkesa zyrtare është me Nr.02-070/0-5-002024-3/25, kjo kërkesë është dorëzuar me datë 11.06.2025, drejtuar Kuvendit Komunal, zyrtarisht kërkesa është dashur të trajtohet, kërkesa është nga z. Burhan Berjani, për ndihmë shëndetësore, të gjitha dokumentet te cilat e arsyetojnë, janë te dorëzuara në arkiv të protokolluara dhe si e till është dashur të vij dhe të trajtohet.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ky person ka qenë ditën kur kemi mbajtur seancë, më ka akuzuar skajshmërisë dhe kam tentuar ta qetësoj atë dhe ta ruaj vetën, ju duhet me ja sqaruar atij, se Kryesuesi i Kuvendit nuk ka pranuar asnjë kërkesë dhe në momentin e par që unë e pranoj, në mbledhjen e radhës unë e sjell, sepse ne e kemi hap atë portë, e masa ndej a merr vota apo jo nuk e di. Unë kam qenë në Haxh dhe ndoshta kjo ka qen arsyeja pse nuk me ka ardhur. Sepse me akuzoj, do ta shoh mos është ndonjë gabim teknik.

Laureat Gojnovci: Sa i përket pikës së cilës e propozoi z. Bashkim Krasniqi, mendoj se është vetëm çështje procedurale. Ju that se të ka keqpërdor, në këtë rast i bjen që qytetari e ka keqpërdor anëtarin e Kuvendit, ku mendoj se ka ndodh e kundërta, ne jemi në një fushat zgjedhore dhe politizimi, në raste të tilla është turp, manipulimet me raste të tilla është i ulët, në ditën kur u mbajt seanca, qytetari i cili është i afërm i imi dhe i Etnikut, e që kolegu nga grupi parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, në baza javore, mujore i del në ndihmë asaj familje dhe për mua dhe për z. Etnik Berjanin, kishte qen turp nëse ajo pik ish ardh edhe ne nuk e kishim përkrahë. Mënyra qysh ju ka interpretuar qytetarit dhe qysh me ka takuar mua, ka qen keqinformimi nga kolegu i

këtij Kuvendi Komunal, unë e kam propozuar, kam folur, sepse nuk ka folur as z. Etnik Berjani dhe as z. Laureat Gojnovci dhe askush, kjo është turp. Qysh mundemi ne me votuar një kërkesë kur kjo kërkesë nuk ka ardhur zyrtarisht. Turp mu keqpërdorë një qytetar, nga një anëtar i Kuvendit për një fushat, për poen politik.

Vlonjat Hasani: Kryesues kërkoj zyrtarisht, nga ju dhe procesmbajtësi i këtij procesverbali, që ta dëshmojnë me argumentin, qoftë edhe me videoincizim apo me shkrim, me detaje në çdo moment të seancës, prej fillimit të saj me datë 30.06.2025, kush çka ka thënë, si është drejtuar dhe çka është drejtuar. Kur i keni lexuar pikat e rendit të ditës, ju kujtohet dhe kur Hasani ka propozuar për pikën të cilën nuk kaloj, para se me i qit në votim pikat e rendit të ditës, e kam kërkuar fjalën, ku kam pyetur Kryesuesin e Kuvendit të Komunës, Kryesues është një kërkesë, e një bashkëvendësit tonë, ku as emrin nuk ja kam përmend, për shkak se nuk ka nevojë me ja përmend emrin dikujt, për deri sa ka kërkesë zyrtare, ju më keni thënë që mua nuk më ka ardhur asnjë kërkesë. Kërkesa nuk është trajtuar dhe ka filluar procesi i seancës.

Personi në fjalë z. Burhan Berjani, nuk me intereson familjar i kujt është, sepse ai është qytetar i Komunës së Fushë-Kosovës, i cili i drejtohet dikujt, e ai për fat të mirë ju ka drejtuar të gjithëve, ky ka thënë që vet kryetari Burim Berisha ja ka mbush kërkesën, ai vet më ka thënë, po ashtu më ka pyetur pse nuk ka ardh në Kuvend, unë i kam thënë që Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, më ka thënë që kjo kërkesë nuk ka ardhur prej administratës dhe ja kam sqaruar të njëjtën formë si ju e thatë, sepse ligjërisht duhet me trajtuar, sepse është kërkesë zyrtare, përndryshe këtu nuk është askush duke e keqpërdorur askënd, unë nuk kam përmendur askënd nga asamblistët dhe mundesh me marr dhe publikisht mu sqaruar. Unë i kam thënë që tek te ndryshme kam me dal dhe kam me kërkuar.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Unë ju premtoj se në momentin si të më vjen kërkesa, kam me sjell në Kuvend.

Hasan Ismajli: Unë personalisht nuk e njoh këtë qytetar dhe me von kam marr informata, ai djali ka probleme shëndetësore, unë i kam mesazhet e tije, po ashtu videot që mi ka dërguar se ku jeton ky qytetar, unë nuk bie në grackë dhe kush ja ka dhënë numrin nuk e di, më ka takuar në mbrëmje dhe ka fol shumë, unë te nesërmen e kam takuar z. Hysen Sllamnikun dhe ma ka shpjeguar rastin e tije, pastaj kam takuar z. Ekrem Berjanin dhe Faton Berjanin dhe unë i kam informatat e sakta se kush i ka ndihmuar nga këta, duke filluar nga z. Etnik Berjani, unë i kam thënë ty të kan ndihmuar dhe çka është absurde sa here i ka ndihmuar drejtorja e shëndetësisë, parat janë dalur në konton e kunatës së tij, jetojke në gjendje të mjerueshme dhe unë i kamë thënë, ne mundemi te gjithë me u bërë, si kolgë në Kuvend, me i mbledh 2000€ dhe me i ndihmuar me ia rregullua banoj, por ky prap nesër ka me bërë kështu, nëse vjen kërkesa në Kuvend unë i kam thënë kam me qen njëri nga asamblistët që kam me kërkuar votën e të gjithëve, ky djalë nuk ka nevojë për para, sepse ky nuk din me i menagjuar, ky ka nevojë për një institucion shëndetësorë dhe unë kam propozuar këtë shtëpinë këtu afër. Ju e dini se komuna i ka ndihmuar me dy shtëpi dhe i kanë ndihmuar dhe familjarët shumë. Kështu që mos të na manipulon, sepse po luajke. Ai më tha se në sportel po më thonë që ne e kemi dërguar në zyre dhe Kryesuesi nuk ka dashur me sjell.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim, 'Ndërrimin e anëtarit të Komitetit për Komunitet z. Qerim Gara në vend të z. Hasan Ismaili.

U votua me: unanimitet , kundër nuk ka dhe asnjë abstenim, gjithsej tetëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Kuvendit të Komunës se kalon si pikë e rendit të ditës 'Ndërrimin e anëtarit të Komitetit për Komunitet z. Qerim Gara në vend të z. Hasan Ismaili.

V E N D I M

Për ndryshimin - plotësimin e vendimit Nr. 200, të datës 31.12.2021


1. Për ndryshim - plotësimin e paragrafit 1, nën-paragrafit 1.5, të vendimit Nr. 200, të datës 31.12.2021, për themelimin e Komitetit për Komunitete për të realizuar ndërrimin e përfaqësuesit të Komitetit Ashkalinj nga Lista Ndryshe, duke e larguar z. Artan Asllani nga përbërja e Komitetit për Komunitete prej nëntë anëtarëve dhe për caktimin e z. Qerim Gara në cilësinë e anëtarit të ri të Komitetit për Komunitete.
2. Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit Nr. 200, të datës 31.12.2021, për themelimin e Komitetit për Komunitete në Komunën e Fushë-Kosovës, i cili është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatimin dhe shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht. Komiteti gjithashtu i rekomandon Kuvendit të Komunës, masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komiteteve për tu avansuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të drejtave të Komuniteteve brenda Komunës

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje. Mbledhja përfundoi në ora 11:05 minuta.

Procesmbajtës
Hasan Gjyrevci



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Ali Ismaili



Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Kuvendit të Komunës se kalon si pikë e rendit të ditës 'Ndërrimin e anëtarit të Komitetit për Komunitet z. Qerim Gara në vend të z. Hasan Ismaili.


V E N D I M

Për ndryshimin - plotësimin e vendimit Nr. 200, të datës 31.12.2021

1. Për ndryshim - plotësimin e paragrafit 1, nën-paragrafit 1.5, të vendimit Nr. 200, të datës 31.12.2021, për themelimin e Komitetit për Komunitete për të realizuar ndërrimin e përfaqësuesit të Komunitetit Ashkalinj nga Lista Ndryshe, duke e larguar z. Artan Asllani nga përbërja e Komitetit për Komunitete prej nëntë anëtarëve dhe për caktimin e z. Qerim Gara në cilësinë e anëtarit të ri të Komitetit për Komunitete.
2. Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit Nr. 200, të datës 31.12.2021, për themelimin e Komitetit për Komunitete në Komunën e Fushë-Kosovës, i cili është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatimin dhe shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht. Komiteti gjithashtu i rekomandon Kuvendit të Komunës, masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komiteteve për tu avansuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të drejtave të Komuniteteve brenda Komunës

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje. Mbledhja përfundoi në ora 11:05 minuta.

Procesmbajtës
Hasan Gjyrevci



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Ali Ismaili

